

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:** **PAKR 1282/12**  
**(P 214/11, Gjykata Themelore në Pejë)**

**Datë:** **28 maj 2014**  
**(Aktgjykimi i finalizuar 21 tetor 2014)**

**Gjykata e Apelit**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Timo Vuojolahti, si kryetar i kolegjit, gjyqtares së Gjykatës së Apelit Tonka Berishaj si gjyqtare referuese dhe gjyqtares së EULEX-it Annemarie Meister, si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Beti Hohler dhe këshilltarja ligjore e EULEX-it Vjollca Kroçi-Gërxhaliu si procesmbajtëse,

në procedurën penale kundër të akuzuarve (të pandehurve) në vijim:

- **B.K.**, i lindur më \_\_, në fshatin T., Komuna e P., emri babës N. emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës H. B, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion hidraulik, me gjendje mesatare ekonomike, i dënuar me 27 (njëzet e shtatë) vjet burgim me aktgjykimin KP Nr. 412/2006 të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 19 shtator 2007, të konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP Nr. 153/2008, të datës 12 janar 2010 (apeluar në gjykatë të shkallës së tretë), në paraburgim prej 29 marsit 2012;
- **D.I.** i lindur më \_\_, në fshatin K, Komuna e D, emri babës S emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Sh. B, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike, i dënuar me 5 (pesë) vjet burgim me aktgjykimin P. Nr. 329/2011 të Gjykatës së Qarkut të P, në paraburgim prej 29 marsit 2012;
- **H.K.**, i lindur më \_\_, në fshatin T., Komuna e P, emri babës N, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës H.B, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, bujk, me gjendje mesatare ekonomike, në paraburgim prej 17 dhjetorit 2010;
- **A.N.**, i lindur më \_\_, në fshatin G, Komuna e D, me banim në rrugën \_\_ Nr. \_\_, në P., emri i babës Rexhë, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Gj. U, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, p, me gjendje mesatare ekonomike, në paraburgim prej 10 tetorit 2010;

- **I.L.**, i lindur më \_\_\_, në fshatin S.i U, Komuna e D, emri babës Z, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës F.K, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion nëpunës i sigurimit, me gjendje mesatare ekonomike, i mbajtur në paraburgim prej 10 tetorit 2010 deri më 7 prill 2011 dhe nga data 3 maj 2012 deri me 15 maj 2014;
- **H.K.**, i lindur më \_\_\_, në P, emri babës Z, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës N. Sh, i martuar, ka një fëmijë, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës, me gjendje mesatare ekonomike, i mbajtur në paraburgim prej 15 tetorit 2010 deri më 7 prill 2011 dhe prej 3 majit 2012 e tutje;
- **S.G.**, i lindur më \_\_\_, në fshatin B, Komuna e D, emri babës R. emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës A. K, i martuar, ka një fëmijë, Sh, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje mesatare ekonomike, i mbajtur në paraburgim prej 15 tetorit 2010 deri më 7 prill 2011 dhe prej 3 majit 2012 e tutje;

*Të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale PPS. Nr. 102/2010 të datës 31 mars 2011, të ndryshuar më 24 prill 2012, për pikat e veprave penale në vijim:*

- **Pika 1;** kundër të akuzuarve B.K., D.I., H.K., A.N., I.L, H.K. dhe S.G., për bashkëkryerje të veprave penale të krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274 (1) lidhur me veprën penale të rrëmbimit në kundërshtim të nenit 159 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK)<sup>1</sup>;
- **Pika 2.1;** kundër B.K.t, vepra penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 (3) të KPK-së;
- **Pika 2.2;** kundër B.K.t, vepra penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në kundërshtim të nenit 317 (1) të KPK-së;
- **Pika 3;** kundër D.I, vepra penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 (2) të KPK-së;
- **Pika 4;** kundër H.K.t, vepra penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 (1) dhe (2) të KPK-së; dhe
- **Pika 5;** kundër H.K, vepra penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 (2) të KPK-së;

---

<sup>1</sup> Kodi Penal në fuqi prej 6.04.2004 deri 31.12.2012.

*Të shpallur fajtorë nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P. Nr. 214/11, të datës 3 maj 2012 të Gjykatës së Qarkut të Pejës si në vijim:*

- I pandehuri **B.K.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim dhe me gjobë me 200.000 euro; për veprën penale nga pika 2.1 i dënuar me tre (3) vjet burgim, dhe i liruar për veprën penale nga pika 2.2; i dënuar me dënim unik me shtatëmbëdhjetë (17) vjet burgim dhe me gjobë me 200.000 euro, në përputhje me nenin 71 (1) dhe (2) 2) të KPK-së; me konfiskim si dënim plotësues;
- I pandehuri **D.I.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim dhe me gjobë me 180.000 euro; për veprën penale nga pika 3 dhe i dënuar me dy (2) vjet burgim; i dënuar me dënim unik me trembëdhjetë (13) vjet burgim dhe me gjobë me 180.000 euro, në përputhje me nenin 71 (1) dhe (2) 2) të KPK-së;; me konfiskim si dënim plotësues;
- I pandehuri **H.K.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me njëmbëdhjetë (11) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro; për veprën penale nga pika 4 dhe i dënuar me dy (2) vjet burgim; i dënuar me dënim unik me dymbëdhjetë (12) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro në përputhje me nenin 71 paragrafin 1 dhe (2) 2) të KPK-së;;
- I pandehuri **A.N.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro; me konfiskim si dënim plotësues;
- I pandehuri **H.K.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me dhjetë (10) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro; për veprën penale nga pika 5 dhe i dënuar me një (1) vjet burgim; i dënuar me dënim unik me dhjetë (10) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe me gjobë me 150.000 euro në përputhje me nenin 71 (1) dhe 2 (2) të KPK-së; me konfiskim si dënim plotësues;
- I pandehuri **S.G.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me dhjetë (10) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro;
- I pandehuri **I.L.** për veprën penale nga pika 1 dhe i dënuar me dhjetë (10) vjet burgim dhe me gjobë me 150.000 euro;

**Duke vepruar në lidhje me ankesat në vijim kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 3 maj 2012 nr P. 214/11 (tash e tutje: aktgjykimi i kundërshtuar):**

- **Ankesën e avokatit mbrojtës M.H.. të paraqitur në emër të të akuzuarit B.K., më 13.08.2011 dhe të plotësuar më 13.09.2013;**

- Ankesën e avokatit mbrojtës G.B. të paraqitur në emër të të akuzuarit D.I., më 02.08.2012;
- Ankesën e avokatit mbrojtës O.B. të paraqitur në emër të të akuzuarit H.K., më 02.08.2012;
- Ankesën e avokatit mbrojtës H.Ç.të paraqitur në emër të të akuzuarit A.N., më 07.08.2012;
- Ankesën e avokatit mbrojtës Xh.R.të paraqitur në emër të të akuzuarit I.L., më 10.08.2012;
- Ankesën e avokatit mbrojtës Q.M. të paraqitur në emër të të akuzuarit H.K., më 07.08.2012; dhe
- Ankesën e avokatit mbrojtës G.K.të paraqitur në emër të të akuzuarit S.G., më 06.08.2012;

*pas shqyrtimit të përgjigjes së Prokurorit të Apelit të Shtetit të Kosovës PAR/I. Nr. 485/14 të datës 10 prill 2014;*

*pas mbajtjes së seancës së kolegjit në përputhje me nenin 410 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) më 20 shkurt dhe 18 mars 2014;*

*pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 18 mars 2014, 25 mars 2014, 15 prill 2014, 14 maj 2014, 15 maj 2014 dhe 28 maj 2014;*

*në përputhje me nenet 420 dhe në vijim të KPPK-së,*

*lëshon këtë:*

---

## AKTGJYKIM

---

**I. Ankesat e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve B.K., D.I., H.K., A.N., H.K. dhe S.G., pranohen pjesërisht. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës P. nr. 214/ 11 i datës 03.05.2012 ndryshohet sa i përket cilësimit juridik dhe vendimit mbi dënimin, si në vijim:**

**1. Nën pikën 1: i akuzuari B.K., D.I., H.K., A.N., H.K. dhe S.G., përmes veprimeve të përshkruara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar, ne bashkryerje kanë kryer veprën penale të rrëmbimit të personit nga neni 159 (2) i KPK-së dhe neni 23 te KPK-së. Ata lirohen nga akuzat për kryerje të veprës penale të krimit të organizuar në përputhje me nenin 274 (1) të KPK-së.**

2. **Nën pikën 3:** i akuzuari **D.I.** amnistohet, në pajtim me nenin 2, nenin 3 (1.2) 1.2.5), dhe nenin 7 (1) 1.1) të Ligjit për Amnistinë (04/L-209), për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (2) të KPK-së. Akuzat nga pika 3 refuzohen në përputhje me nenin 389 (4) të KPPK-së, dhe dënimi për veprën penale nga pika 3, hedhet poshtë.

3. **Nën pikën 5:** i akuzuari **H.K.** amnistohet, në pajtim me nenin 2, nenin 3 (1.2) 1.2.5 ), dhe nenin 7 (1) 1.1) të Ligjit për Amnistinë (04/L-209), për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (2) të KPK-së. Akuzat nga pika 5 refuzohen në përputhje me nenin 389 (4) të KPPK-së, dhe dënimi për veprën penale nga pika 5 hedhet poshtë.

4. Ndaj të pandehurve janë shqiptuar dënimet në vijim:

- I akuzuari **B.K.** dënohet për pikën 1 me 10 (dhjetë) vjet burgim për veprën penale të rrëmbimit të personit në përputhje me nenin 159(2) të KPK-së. Duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për pikën 2.1 për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (3) të KPK-së (tri vite burgim), i pandehuri në përputhje me nenin 71 të KPK-së dënohet me dënim unik me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.03 2012 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

- I akuzuari **D.I.** dënohet për pikën 1 me 8 (tetë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.03.2012 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

- I akuzuari **H.K.** dënohet për pikën 1 me 6 (gjashtë) vjet burgim për veprën penale të rrëmbimit të personit në përputhje me nenin 159(2) të KPK-së. Duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për pikën 4 për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (3) të KPK-së (dy vite burgim) , i pandehuri në përputhje me nenin 71 të KPK-së dënohet me dënim unik me 7 (shtatë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 17.12.2010 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

- I akuzuari A.N. dënohet për pikën 1 me 9 (nëntë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.10.2010 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

- I akuzuari H.K. dënohet për pikën 1 me 6 (gjashtë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.10.2010 deri 7.04.2011 dhe prej datës 03.05.2012 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

- I akuzuari S.G. dënohet për pikën 1 me 6 (gjashtë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.10.2010 deri 7.04.2011 dhe prej datës 03.05.2012 deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet në dënim.

**II. Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës i të akuzuarit I.L. pranohet. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës P. nr. 214/ 11 i datës 03.05.2012 ndryshohet, si në vijim:**

1. Në përputhje me nenin 390 (1) të KPPK-së, i akuzuari I.L. **LIROHET** nga të gjitha akuzat për kryerje të veprës penale të krimit të organizuar në bashkëkryerje me B.K.n, D.I.n, A.N.n, H.K.n, H.K.n dhe S.G.n, në përputhje me nenin 274 (1), dhe për veprën penale të rrëmbimit të personit, sipas nenit 159 (2) të KPK-së;
2. I akuzuari I.L. lirohet nga dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut.
3. Paraburgimi kundër të akuzuarit I.L. ndërpritet me aktvendim të veçantë.
4. I akuzuari I.L. lirohet nga obligimi për pagesën e shpenzimeve të procedurës. Shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin I.L. mbulohen nga buxheti i gjykatës.

**III. Deri më tani nuk është bërë ndryshimi siç u përmend më lart, dispozitivi i aktgjykit të kundërshtuar mbetet i pandryshuar dhe vërtetohet.**

## ARSYETIMI

### **I HISTORIA E PROCEDURËS**

#### **1. Procedura**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (tash e tutje PSRK, prokurori special) më 7 prill 2011 ngriti aktakuzën PPS. 102/2010 të datës 31.03.2011 para Gjykatës së Qarkut në Pejë kundër të pandehurve.

Aktakuza u konfirmua në tërësi me aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës KA nr. 143/2011, të datës 20 maj 2011.

Shqyrtimi gjyqësor në lëndën penale filloi më 8 shtator 2011. Të gjithë të pandehurit i deklaruar të pafajshëm. Të gjithë deklaruar se nuk ishin të përfshirë në rrëmbimin e viktimës A.M..

Në seancën gjyqësore të datës 24 prill 2012, prokurori special në fjalën e tij përmbyllëse e ndryshoi aktakuzën përkitazi me I.L.n duke pohuar se:

“... provat e administruara në seancë gjyqësore kanë kontribuar në vërtetimin e saktë të gjendjes faktike ashtu që në rreshtin 8 të faqes 2 të aktakuzës në versionin në gjuhën shqipe pas datës 22 shtator 2010, duhet të shtohen fjalët në vijim: ‘*Pasi bariu e kuptoi se një person po mbahej i mbyllur në kasolle, rrëmbyesi i cili e identifikoi veten para dëshmitarit DI si M., kërkoi nga ai t’i tregonte se ku mund të bënte një telefonatë dhe më pastaj me telefonin e dëshmitarit DI, 04....., në orën 11:31, ka thirrur të akuzuarin I.L. në numrin e tij 04..... ku i ka thënë të vijë dhe t’i marrtë ata.*’”

Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 3 maj 2012. Në ditën e njëjtë, Gjykata e Qarkut lëshoi aktgjykimin P. Nr. 214/11. Të pandehurit më vonë kanë paraqitur ankesa në shkallë të apelit ndaj këtij aktgjykimi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit mbajti seancë për këtë lëndë më 20 shkurt dhe 18 mars 2014; dhe mbajti këshillimet më 18 mars 2014, 25 mars 2014, 15 prill 2014, 14 maj 2014, 15 maj 2014 dhe 28 maj 2014.

Në seancën e këshillimit më 15 maj 2014, kolegji vendosi njëzëri që i pandehuri I.L. të lirohet nga të gjitha akuzat nga aktakuza në këtë lëndë. Prandaj i pandehuri është liruar

menjëherë nga paraburgimi, sipas aktvendimit të veçantë të lëshuar nga kolegji më 15 maj 2014.

## **2. Aktgjykimi i kundërshtuar**

Të pandehurit janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprave penale siç përmendet më lart.

Sa i përket veprës penale të krimit të organizuar lidhur me veprën penale të rrëmbimit (pika 1), Gjykata e Qarkut gjen se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar, se më 21 shtator 2010 të pandehurit, duke vepruar si grup i organizuar kriminal, secili me role të caktuara paraprakisht dhe me qëllim të përfitimit të paligjshëm material, dhe duke përdorur dunë dhe nën kërcënim të dhunës, të armatosur me pistoleta dhe me një pushtë automatike AK47, kanë rrëmbyer viktimën A.M.. Viktimën e kanë mbajtur si peng dhe kanë kërkuar pagesë për haraç. Viktima është liruar më 30 tetor 2010.

Të pandehurit janë dënuar siç përmendet më lart. Periudhat përkatëse të kaluara në paraburgim janë llogaritur në dëmin sipas urdhrit. Armët dhe municioni të mbajtur në posedim të paligjshëm janë konfiskuar. Vetura Toyota 4-runner, pronë e A.N.t, u konfiskua. Të pandehurit janë urdhëruar t'i paguajnë shpenzimet e procedurës.

Më 3 maj 2012 Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi aktvendim për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurve I.L., H.K. dhe S.G. deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Gjykata po ashtu e vazhdoi masën e paraburgimit kundër të pandehurve B.K., D.I., H.K. dhe A.N. deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Avokatët mbrojtës përkatës paraqitën ankesa kundër aktgjykit të Gjykatës së Qarkut të Pejës (P. Nr. 214/11), të datës 3 maj 2012, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente e shkallës së dytë në atë kohë. Në përputhje me nenin 39 (1) të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199) më 1.01.2013 lënda u bart në Gjykatë të Apelit.

Prokurori Special nuk paraqiti ankesë kundër aktgjykit e as përgjigje ndaj ankesave të paraqitura. Më 19 dhjetor 2012 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit paraqiti propozimin (PPA.nr. 578/12), në përputhje me ligjin, duke i propozuar gjykatës që t'i refuzojë ankesat si të pabazuara dhe ta vërtetojë aktgjykimin e kundërshtuar.

## **II PARASHITRESAT E PALËVE**

Avokati mbrojtës për të pandehurin **B.K.**, avokati M.H, e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të



vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të shkeljeve të ligjit penal si dhe e kundërshton vendimin mbi dënimin. Ai propozon që gjykata e apelit ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe konstaton se nuk është vërtetuar se i pandehuri B.K. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe ta lirojë nga aktakuza në përputhje me nenin 390 (3) të KPPK-së, ose ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim. Sidoqoftë, aktgjykimi duhet të ndryshohet në aspektin e cilësimit juridik ashtu që i pandehuri të dënohet vetëm për veprën penale të rrëmbimit nga neni 159 (3) i KPK-së dhe duhet të shqiptohet një dëmi më i lehtë.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **D.I.**, avokati G.B., e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të shkeljeve të ligjit penal dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai propozon që gjykata ta ndryshojë aktgjykimin e apeluar dhe ta lirojë të pandehurin D.I. nga akuza ose ta anulojë aktgjykimin e apeluar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **H.K.**, avokati O.B., e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të shkeljeve të ligjit penal si dhe e kundërshton vendimin mbi dënimin. Ai propozon që gjykata ta ndryshojë aktgjykimin e apeluar dhe në mungesë të provave ta lirojë të pandehurin nga akuza, ose ta anulojë aktgjykimin e apeluar përkitazi me këtë të pandehur dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **A.N.**, avokati H.Ç, e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar në të gjitha bazat ligjore, d.m.th. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të shkeljeve të ligjit penal si dhe e kundërshton vendimin mbi dënimin. Ai propozon që gjykata e shkallës së dytë ta pranojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e apeluar dhe ta lirojë të pandehurin A.N. nga akuza në kuptim të nenit 390, (3) të KPPK-së ose ta anulojë aktgjykimin e apeluar dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **I.L.**, avokati XH. R., e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të shkeljeve të ligjit penal dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai propozon që gjykata e shkallës së dytë ta anulojë aktgjykimin e apeluar në tërësi ose ta ndryshojë në mënyrë që ta lirojë të pandehurin I.L. nga akuza.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **H.K.**, avokati Q.M., e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të shkeljeve të ligjit penal dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe

për shkak të vendimit mbi dënimin me burgim dhe me gjobë. Ai propozon që gjykata ta pranojë ankesën e tij si të bazuar, kurse ta ndryshojë aktgjykimin e apeluar në mënyrë që të pandehurin H.K. ta lirojë nga aktakuza në përputhje me dispozitën e nenit 390 (1) 3) të KPPK-së për veprën penale të krimit të organizuar nga neni 274 (1) në lidhje me veprën penale të rrëmbimit nga neni 159 (2) i KPK-së, kurse për veprën penale nga neni 328 (2) i KPK-së – gjykata të shqiptojë një dënim më të lehtë, ose ta anulojë aktgjykimin e apeluar dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **S.G.**, avokati G.K, e kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të shkeljeve të ligjit penal dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai propozon që gjykata e shkallës së dytë ta pranojë ankesën e tij, ta anulojë aktgjykimin e apeluar dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim ose ta ndryshojë aktgjykimin e apeluar në mënyrë që i pandehuri S.G. të dënohet me një dënim më të lehtë.

Prokurori i Shtetit i **Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**, me anë të parashtrësës së datës 19 dhjetor 2012, në përputhje me nenin 409 (2) të KPPK-së, propozon që Gjkata t'i refuzojë si të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës për të pandehurit B.K, D.I, H.K, A.N, I.L, H.K. dhe S.G, dhe ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës P. Nr 214/2011 të datës 3 maj 2012.

### **III GJETJET E GJYKATËS SË APELIT**

#### **A. Cështjet procedurale preliminare**

##### **A.1. Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e kolegjit**

Gjkata e Apelit është gjykata kompetente për gjykimin e ankesave të paraqitura nga palët kundër aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së parë, në përputhje me nenet 17 dhe 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është i përbërë në pajtim me nenin 19 (1) të Ligjit për Gjykatat dhe me nenin (3) të ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053).

Kolegji i përfundoi këshillimet më 28 maj 2014.

##### **A.2. Pranueshmëria e ankesave dhe e përgjigjes**

Aktgjykimi i apeluar është lëshuar më 3 maj 2012. Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit B.K. më 26 korrik 2012. Më 27 korrik 2012 është bërë përpjekje t'i dorëzohet aktgjykimi

të pandehurit A.N. në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, por ai refuzoi ta pranojë. Të gjithë të pandehurit e tjerë H.K., H.K., D.I., S.G. dhe I.L. e pranuan aktgjykimin e kundërshtuar më 27 korrik 2012.

Avokati mbrojtës M.H. e pranoi aktgjykimin e kundërshtuar më 26 korrik 2012. Ankesa e tij në emër të të pandehurit B.K. u regjistrua më 13 gusht 2012. Në ankesë, avokati mbrojtës ka shkruar se do ta plotësojë atë më 13 shtator 2012. Avokati mbrojtës vërtetë e paraqiti një parashtrësë plotësuese në atë ditë. Gjykata e Apelit, pas rishikimit të parashtrësës së tij, konstatoi se ajo shtjellon bazat e ankesës të ngritura në ankesën e parë, të paraqitur më 26 korrik 2012. Pasi që nuk është ngritur asnjë argument i ri, dhe ankesa thjesht vetëm shtjellon argumentet e ngritura më parë, kolegji konsideron se plotësimi është i pranueshëm.

Avokati mbrojtës H.Ç.dhe G.K. e pranuan aktgjykimin më 24 korrik 2012, kurse avokati mbrojtës Q.M., Avokati mbrojtës O.B., avokati mbrojtës G.B. dhe Xh.R. e pranuan aktgjykimin më 23 korrik 2012. Ankesat e avokatit mbrojtës G.B. dhe O.B. u regjistruan në shkrimore të gjykatës më 2 gusht 2012, ankesa e avokatit mbrojtës G.K. më 6 gusht 2012, ankesa e avokatit mbrojtës H.Ç.më 7 gusht 2012, ankesa e avokatit mbrojtës Q.M. më 7 gusht 2012 dhe ankesa e avokatit mbrojtës Xh.R.më 10 gusht 2012.

Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se ankesat janë të paraqitura me kohë nga personat e autorizuar në pajtim me nenin 398 (1) dhe nenin 399 (1) të KPPK-së dhe prandaj të gjitha janë të pranueshme.

Më tutje, vlen të theksohet se në bazë të autorizimit të lëshuar nga V.G. më 5 tetor 2012, avokati mbrojtës M.D. tani përfaqëson të pandehurin S.G..

## **B. Shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës penale**

Avokatët mbrojtës të të pandehurve pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar përfshin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 (1) 4) 8) 9) 10) 12) dhe (2), 1) i KPPK-së, përkatësisht se është shkelur parimi i publicitetit të seancave gjyqësore i mbrojtur nga KPPK-ja; se aktgjykimi i apeluar është i mbështetur në prova të papranueshme (procedura e identifikimit me dëshmitarin A.M., procesverbali i bastisjes së shtëpisë për të pandehurin B.K. dhe certifikata për sendet e konfiskuara , provat e telekomunikimeve dhe fotografimet në hartë, deklaratat e dëshmitarëve D1, F.Ç. dhe M.K.); se aktgjykimi i apeluar nuk përmban arsyetim sa i përket fakteve vendimtare, se arsyet janë kundërthënëse dhe të paqarta në shkallë të konsiderueshme, se aktgjykimi i apeluar nuk ka paraqitur qartë dhe plotësisht se cilat fakte dhe për cilat arsye konsideron se

ato janë të vërtetuara apo jo, se aktgjykimi i apeluar nuk ka ofruar arsye për pranimin e propozimeve të palëve.

Kolegji gjen se pretendimet e tilla ankimore të avokatëve mbrojtës të të pandehurve B.K., D.I., H.K., A.N., H.K. dhe S.G. janë të pabazuara.

Kolegji do të shtjellojë mbi çështjet e kundërshtuara në ankesa dhe arsyet pse këto kundërshtime janë refuzuar. Me qëllim që kjo të bëhet sa më logjiksht dhe sa më qartë, çështjet e ngritura në të gjitha ankesat do të trajtohen sipas rendit të përcaktuar me ligj.

### **B.1. Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor: neni 403 (1) 4) i KPPK-së**

Avokati mbrojtës për të pandehurin H.K., avokati O.B., pretendon se publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në shkelje të ligjit, sepse shqyrtimi është mbajtur në objektet e Burgut të Dubravës, dhe se publiku nuk është lejuar të shkojnë kur kanë dëshiruar, që të qëndrojnë aty sa kanë dëshiruar apo që të largohen kur kanë dëshiruar, siç veprohet zakonisht me publikun në gjykatë.

Me dispozitën e nenit 328 (1) të KPPK-së, përcaktohet që procedura gjyqësore është e hapur për publik. Përveç kësaj, me dispozitën e nenit 320 (1) të KPPK-së, përcaktohet se: *“Shqyrtimi gjyqësor mbahet në selinë e gjykatës dhe në ndërtesën e gjykatës”,* kurse paragrafi (2) i kësaj dispozite përcakton se *“kur në raste të caktuara lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor ose për shkaqe të tjera të ngjashme të arsyeshme, kryetari i gjykatës mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në ndonjë ndërtesë tjetër”* dhe paragrafi 3 i dispozitës së njëjtë përcakton se *shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe në vend tjetër në territorin e gjykatës kompetente kur këtë, në bazë të propozimit të arsyetuar të kryetarit të gjykatës, e lejon kryetari i gjykatës më të lartë.”*

Pas analizimit të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 20 shtator 2011, është vërtetuar se pas hapjes së seancës gjyqësore, kryetari i trupit gjykues bëri vërejtje se shqyrtimi gjyqësor është i hapur. Lidhur me lokacionin e seancës gjyqësore ishte bërë e qartë se për arsye teknike gjykimi është mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, sepse gjykatoret në Gjykatën e Qarkut në Pejë janë shumë të vogla për gjykimin e një numri kaq të madh të të pandehurve. Për më shumë, urdhri për caktimin e shqyrtimit gjyqësor i datës 4 korrik 2011 qartëson se gjykimi është i hapur për publik dhe se pjesëtarët e publikut që dëshirojnë të marrin pjesë së gjykim duhet ta njoftojnë gjykatën së paku 48 orë përpara datës së mbajtjes së seancës.

Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Gjykata e Apelit konstaton se të drejtat e palëve nuk janë shkelur dhe se publiku nuk është përjashtuar nga gjykimi i kësaj lënde. Prandaj nuk ka asnjë shkelje sipas nenit 403 (1) 4) të KPPK-së.

Numri i të pandehurve, çështjet e sigurisë së lartë për të pandehurit<sup>2</sup> dhe infrastruktura e papërshtatshme e Gjykatës së Qarkut të Pejës të gjitha janë rrethana objektive të cilat diktuan ndryshimin e vendit të mbajtjes së gjyqimit. Zgjidhja e vetme e realizueshme në atë kohë ishte vërtetë mbajtja e gjyqimit në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë. Për shkak të arsyeve teknike kishte disa restriksione për publikun, mirëpo publiku nuk ishte përjashtuar dhe nuk ka pasur shkelje të ligjit të procedurës në këtë aspekt. Qëllimi i publicitetit të gjyqimit është që të sigurohet transparenca dhe vështrimi i kujdesshëm i procedurës gjyqësore dhe ky qëllim është arritur në këtë lëndë. Publiku është lejuar dhe është ftuar të marrë pjesë në gjykim, prandaj transparenca dhe vështrimi i kujdesshëm është garantuar. Aranzhimet teknike që kërkojnë leje për të marrë pjesë dhe çështja që publiku nuk ka mundur të vijë dhe të shkojë kur kanë dëshiruar nuk kanë pasur ndikim në publicitetin e gjyqimit në kuptimin e nenit 403 (1) 4) të KPPK-së.

## **B.2. Pranueshmëria e provave: Neni 403 (1) 8) i KPPK-së**

### ***B.2.1. Procedura e identifikimit me dëshmitarin A.M.***

Sipas pikëpamjeve të avokatëve mbrojtës, gjykata e shkallës së parë ka pranuar në mënyrë të paligjshme si provë të pranueshme procesverbalin e identifikimit të personave të palës së dëmtuar A.M.. Mbrojtja argumenton se procedura e identifikimit ishte bërë në shkelje të dispozitave të nenit 255 të KPPK-së, prandaj prova është e papranueshme.

### Cështja

Më 3 nëntor 2010 A.M. i janë treguar fotografitë e 20 personave (derisa prokurori ishte duke e intervistuar). Nuk ekziston asnjë dokument që do ta qartësonte se cilat fotografi ia kanë treguar.

Më 30 dhjetor 2010, A.M. mori pjesë në procedurën e identifikimit. Polici hetues (H, shih aktgjykimin e kundërshtuar, faqe 28-33) e ka dokumentuar këtë procedurë dhe procesverbali i kësaj procedure të identifikimit është paraqitur si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor (aktgjykimi i kundërshtuar, faqe 22). Sipas policit H., asnjë fotografi nuk i është treguar A.M. para fillimit të procedurës së identifikimit, (aktgjykimi i kundërshtuar, faqe 90, versioni në gjuhën shqipe). Në procedurë të identifikimit në total ishin 25 persona (të rreshtuar). A.M. nuk ka bërë asnjë përshkrim të të dyshuarve para procedurës. Të pandehurit në foto-rreshtim ishin të prangosur dhe disa prej tyre kishin këmbët e lidhura (aktgjykimi i kundërshtuar, faqe 30, 31-32).

---

<sup>2</sup> Njëri nga të pandehurit është arratisur më parë nga burgu.

Më 5 janar 2011 A.M. dha deklaratë para prokurorit në lidhje me procedurën e identifikimit.

Gjykata e Qarkut vendosi se prova e identifikimit është e pranueshme.

Neni 153 (1) i KPPK-së thotë: *“Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.”*

Neni 255 i KPPK-së parashikon rregullat themelore të procedurës së identifikimit siç vijon:

- *Nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruajë dhe tregojë tiparet dalluese të personit*
- *Pastaj dëshmitarit i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre*
- *Dëshmitarit i bëhet me dije se nuk detyrohet të zgjedhë personin ose sendin apo ndonjë fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e njeh personin, sendin ose fotografinë ashtu sikurse të thoshte se e njeh*

### Vlerësimi

Kolegji thekson se çështja e pranueshmërisë së provave nuk duhet të ngatërrohet me çështjen e vlerës provuese të asaj prove. Këto janë dy çështje të ndara.

Kolegji po ashtu thekson se provat mund të shpallen të papranueshme vetëm *kur ligji shprehimisht parashikon kështu*. Në të gjitha rastet tjera, prova është e pranueshme por shkeljet e dispozitave të procedurës mund të ndikojnë në vlerën provuese të provës.

KPPK-ja nuk parashikon që prova e marrë me shkelje të dispozitave të procedurës së identifikimit është e papranueshme.

Identifikimi është një formë e provës. Me përdorimin e kësaj metode përpiqemi të vërtetojmë se çka mban mend dëshmitari; a mund ai/ajo ta njohë personin i cili (disi) ka lidhje me ndodhinë. Rregullat e parashikuara në nenin 255 të KPPK-së kanë për qëllim të sigurojnë që identifikimi të jetë i saktë, që të caktojnë një standard minimal se si duhet të kryhet identifikimi që të jetë i vlefshëm. Përveç rregullave nga neni 255 i KPPK-së janë edhe disa faktorë të tjerë të cilët duhet të merren parasysh për rritjen e vlerës provuese të identifikimit; këto varen shumë nga rrethanat e lëndës.

Si pikënisje, kryerja e procedurës së identifikimit me shkelje të rregullave të sipërpërmendura nuk do të thotë se provat e mbledhura me identifikim duhet të konsiderohen si të papranueshme. Më tepër, ‘procedura e papërshtatshme’ do të thotë se gjykata mund t’i mos japë vlerë të njëjtë provës në krahasim me atë të procedurës së duhur – prandaj kjo është çështje e vlerës së provave. Megjithatë, varësisht nga rrethanat mund të ketë edhe situata kur identifikimi nuk është shprehje e lirë e asaj që dëshmitari e mban mend; në këtë situatë (p.sh. të torturës) i tërë identifikimi mund të konsiderohet si provë e papranueshme.

Kolegji nuk gjen arsye për ta konsideruar procedurës e identifikimit (30 dhjetor 2010) si provë të papranueshme. Megjithatë, procedura e identifikimit ishte zhvilluar në atë mënyrë që e zvogëlon vlerën provuese të identifikimit. Këta faktorë janë:

- Të dyshuarit ishin të prangosur (dhe disa i kishin këmbët e lidhura). Nuk mund të përjashtohet që dëshmitari i ka parë prangat dhe prandaj ka mundur të supozojë se këta janë të dyshuarit e identifikuar nga policia.
- Dëshmitari së pari nuk ka bërë përshkrimin e të dyshuarve.
- Dëshmitari nuk është udhëzuar si duhet.
- Ka dyshime se ‘këta persona’ nuk i kanë përngjarë të dyshuarve.
- Procesverbali i procedurës së identifikimit nuk mund të konsiderohet si i kuptueshëm (shih aktgjykimin e kundërshtuar, faqe 91-92 anglisht).

Si përfundim, kolegji gjen se procedura e identifikimit me dëshmitarin A.M. ka vetëm vlerë të kufizuar provuese, edhe pse është provë e pranueshme. Mirëpo, nuk është prova e vetme e paraqitur lidhur me atë se kush ishin kryerësit.

Gjykata e Apelit konsideron se pretendimet e mbrojtjes të bëra në drejtim të kësaj prove janë të pabazuara.

### ***B.2.2. Procesverbali i kontrollit në shtëpinë e të pandehurit B.K. dhe certifikatat e konfiskimit të sendeve.***

Avokati mbrojtës për të pandehurin B.K. pretendon se procesverbali i kontrollit në shtëpinë e të pandehurit B.K. bashkë me certifikatat e konfiskimit të sendeve janë prova të papranueshme pasi që janë marrë me shkelje të neneve 240-253 të KPPK-së duke rezultuar me faktin se i pandehuri nuk i ka parë në mënyrë specifike apo nuk ia kanë treguar sendet e konfiskuara dhe ka nënshkruar certifikatat pa ditur se në mesin e tyre ishte telefoni që pretendohet se është përdorur për ta kontaktuar dëshmitarin B.M.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e tilla të avokatit mbrojtës për të pandehurin B.K. janë të pabazuara.

Me shqyrtimin e shkresave të lëndës, në veçanti certifikatat e datës 17 dhjetor 2010 mbi konfiskimin e sendeve nga B.K., dhe dëshmitë e dhëna nga policët A.N. dhe A. V, është e qartë se kontrolli është zhvilluar nga persona të autorizuar në bazë të urdhrit të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake (PP Nr 138/10 të datës 20 tetor 2010). Për shkak të rrethanave të dala në kontroll dhe mënyrës se si i pandehuri B.K. veprroi duke u arratisur përmes dritares së hapur, personat zyrtarë vepruan në përputhje me dispozitën e nenit 245 (4) të KPPK-së që parashikon se: *“Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.”*

Për më shumë, lidhur me konfiskimin e sendeve të gjetura gjatë zbatimit të kontrollit, personat zyrtarë kanë vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 243(7) të KPPK-së që parashikon se: *“...Gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen vetëm sendet dhe shkresat lidhur me qëllimin e kontrollit të caktuar. Sendet dhe shkresat e konfiskuara përfshihen dhe përshkruhen qartë në procesverbal dhe shënohen në vërtetimin që menjëherë i jepet personit sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar.”*

Në lëndën konkrete, nga provat e togerit A. V, është vërtetuar se ky dëshmitar personalisht ia ka paraqitur B.K.t sendet e konfiskuara gjatë kontrollit dhe mohon të ketë bërë trysni në të pandehurin për ta nënshkruar vërtetimin e konfiskimit, por i pandehuri B.K. në prani të avokatit mbrojtës e ka nënshkruar atë dokument. Nuk ekziston asnjë provë apo informatë që do ta mbështeste pretendimin e tanishëm të të pandehurit përkitazi me vërtetimin e konfiskimit.

Prandaj, kolegji konsideron se në këtë aspekt, (lidhur me provat në kontroll dhe konfiskimi i sendeve), gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar (faqe 46-50), ka dhënë arsye të qarta dhe bindëse se kjo gjykatë i konsideron të vërteta, prandaj nuk konsideron se është e domosdoshme të japë arsye shtesë lidhur me pretendimet e përmendura.

### ***B.2.3. Provat e telekomunikimeve dhe hartografisë***

Avokati mbrojtës për të pandehurit kundërshton provat e procesverbalit të telekomunikimit dhe të hartografisë, me pretendim se nuk ishte vërtetuar se klientët e tyre kanë përdorur numrat e telefonit siç është gjetur në aktgjykimin e kundërshtuar. Lidhur me provat e hartografisë ata citojnë mendimin e dhënë nga eksperti M. H. i cili nuk e përjashton mundësinë e gabimit deri në 20 kilometra.



Gjykata e Apelit konsideron se pretendimet e mbrojtjes janë të pabazuara. Pas rishikimit të shkresave të lëndës dhe të aktgjykimit të apeluar, kolegji gjen se masat e fshehta për përgjimin e bisedave telefonike dhe telekomunikimet janë aplikuar në bazë të procedurës së parashikuar me dispozitat e KPPK-së dhe kjo gjykatë nuk gjen asnjë shkelje të neneve 258-260 të KPPK-së. Prandaj prova është e pranueshme.

Në fakt, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e apeluar ka paraqitur në hollësi të gjitha faktet lidhur me provat e telefonit mobil. Gjykata e shkallës së parë i ka shoshitur të gjitha çështjet relevante lidhur me SIM kartelat, IMEI numrat, korrelacionit në mes numrave të telefonit mobil dhe IMEI numrave, përdorimi i përbashkët i celularëve, kontaktet e bëra në datat relevante, lokacionet celulare, heshtjet telefonike dhe regjistrat e thirrjeve. Në ankesa nuk ka asgjë që do ta kundërshtonte pranueshmërinë e këtyre provave. Dëshmia e M.H. dhe shpjegimet e këtij eksperti në lidhje me numrat e qendrës së mesazheve që janë paraqitur në regjistrin e thirrjeve telefonike dhe të hartografisë me theks të veçantë në emetimin e sinjaleve në mes dy stacioneve dhe si ato janë shfaqur në detajet hartografike, si dhe valët e antenës komerciale janë bindëse dhe duke u mbështetur në këto prova gjykata e shkallës së parë arriti në përfundim në lidhje me strukturën e lëvizjes në bazë të operimit të antenave dhe të komunikimit në mes të pandehurve. Ky kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë për secilin të pandehur ka paraqitur në mënyrë individuale se cilat SIM kartela ishin mbajtur dhe përdorur gjatë kohës në pyetje, cilat IMEI numra të telefonit, përmbajtjet e regjistrat për kohën që janë përdorur dhe kur kanë pranuar SMS-ët, përmbajtjen e tyre dhe numrat e përdorur për të komunikuar dhe për të këmbyer SMS-ët. Sa i përket pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata e Apelit i referohet edhe gjetjeve dhe përfundimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe e pranon arsyetimin e paraqitur në aktgjykimin e kundërshtuar në tërësi dhe nuk konsideron se është e domosdoshme të përsëritet edhe një herë (aktgjykimi i kundërshtuar, faqe 119-159). Nuk ka asnjë dyshim se kjo provë është e pranueshme . Për më tepër, është prova e besueshme kyçe në këtë lëndë.

#### ***B.2.4. Deklaratat e dëshmitarëve D1/M1 dhe e A.M.***

Avokati mbrojtës për të pandehurit B.K. dhe A.N. pretendon se deklaratat e dëshmitarit D1, të dhëna më 16 dhjetor 2010 dhe më 9 nëntor 2010, intervista e dëshmitarit M1, dhe deklarata e palës së dëmtuar A.M. më 5 janar 2011 janë prova të papranueshme sepse të pandehurit dhe avokatit të tyre mbrojtës nuk iu ka dhënë mundësia për t'i kundërshtuar deklaratat përmes marrjes në pyetje. Dëshmitë ishin dhënë në fazë të procedurës paraprake në polici dhe në prokurori pa i ftuar të pandehurit dhe avokatin mbrojtës.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mbrojtjes janë të pabazuara.

Së pari, nuk ka asnjë dyshim se dëshmitari D1 është personi i njëjtë i cili në polici gjatë procedurës së hetimit ishte intervistuar si dëshmitari M1. Mohimi i dëshmitarit D1 në shqyrtim gjyqësor në bazë se nuk e ka nënshkruar procesverbalin e intervistës së dëshmitarit me shenjë M1 nuk e ndryshon faktin se M1 dhe D1 janë një dhe personi i njëjtë. Siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, togeri L.K. gjatë gjykimit i ka qartësuar rrethanat në lidhje me dëshminë e dëshmitarit D1 në polici, ku ka dëshmuar se fillimisht ky dëshmitar e kishte të caktuar kodin “dëshmitari M1” dhe konfirmoi se dëshmitari M1 dhe D1 janë i njëjti person.

Së dyti, Gjykata e Apelit i referohet arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me propozimin e avokatit mbrojtës të të pandehurve për caktimin e ekspertit të grafologjisë. Prandaj, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se dëshmitari D1 ka dhënë deklaratë vullnetarisht para policisë më 9 nëntor 2010 dhe para prokurorisë më 16 dhjetor 2010, dhe se dëshmitari D1 ka nënshkruar deklaratën e dhënë para policisë dhe procesverbalin e intervistës para prokurorisë, është i saktë dhe si i tillë pranohet nga Gjykata e Apelit.

Është fakt se kur dëshmitari D1 (M1) ishte intervistuar para policisë dhe para prokurorisë, të pandehurit dhe avokati i tyre mbrojtës nuk ishin ftuar dhe nuk ishin të pranishëm. Kjo do të thotë se nuk i është dhënë mundësia për ta kundërshtuar një dëshmi të tillë me anë të marrjes në pyetje *në atë fazë*.

Megjithatë, me dispozitën e nenit 156 (2) të KPPK-së parashihet se: *“Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit **gjatë ndonjë faze të procedurës penale.**”*

Gjykata e Apelit ka vërtetuar se mbrojtja i është dhënë mundësia për ta marrë në pyetje dëshmitarin në shqyrtim gjyqësor, prandaj nuk ka asnjë shkelje sipas nenit 156 të KPPK-së.

Pas rishikimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, është konfirmuar se të pandehurit dhe avokati i tyre mbrojtës e kishte mundësinë për të bërë pyetje, dhe këtë e kanë bërë, dëshmitarit D1 dhe palës së dëmtuar, dëshmitarit A.M., në seancën gjyqësore ku të dytë kanë dëshmuar.

Duke marrë parasysh atë çka u tha më lart, rezulton se procesverbali i intervistës së dëshmitarit M1 (D1) në polici më 09.11.2010, dhe para gjyqtarit të procedurës paraprake të EULEX-it më 08.12.2010 dhe dëshmia para prokurorit më 16.12.2010, janë prova të pranueshme sepse janë marrë në përputhje me dispozitat e procedurës penale për marrjen në pyetje të dëshmitarit. Mbrojtja e kishte mundësinë e kundërshtimit të deklaratave gjatë

shqyrtimit gjyqësor. Njëjtë, mbrojtja e kishte mundësinë t'i kundërshtonte deklaratat e A.M. gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji përfundon se aktgjykimi mund të mbështetet në këto deklaratat të dëshmitarëve.

#### ***B.2.5. Deklarata e dëshmitarit F.Ç.***

Mbrojtja e B.K.t po ashtu e kundërshton deklaratën e dëshmitarit F.Ç. pa specifikuar cilat janë shkeljet e supozuara të gjykatës. Në të vërtetë, arsyetimi i ankesës në këtë çështje është i paqartë.

Mbrojtja tenton të kundërshtojë pranueshmërinë e provave të këtij dëshmitari, dhe argumenti i tillë është i pabazuar. Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë shkelje që do ta bënte dëshminë e tij të papranueshme.

Mbrojtja ngrit çështjen e besueshmërisë së provave të këtij dëshmitari; kurse kolegji gjen se argumentet e ankuesit në këtë drejtim nuk janë bindëse. Edhe pse kjo çështje është e lidhur me kundërshtimet që kanë të bëjnë më shumë me gjetjet e gjendjes faktike, kolegji konstaton se është e udhës të diskutohet për besueshmërinë e kësaj provës.

Dëshmitari F.Ç. ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor të mbajtur më 11 tetor 2011. Gjatë dëshmisë së tij, ai i bëri me diej gjykatës se në malin M. ishte vetë dhe kishte parë dy ose tre burra afër stanit në B. në një distancë prej 50 metrash, të cilët nuk i ka njohur e as nuk ka biseduar. Ai konfirmoi se nuk ka parë armë te ta dhe i përshkroi si persona të zakonshëm, jo me ndonjë rëndësi të veçantë. Ai dëshmoi se është takuar me N. K., babanë e B. dhe H.K.t në B.të P, sepse e njohte prej 30 vitesh, se është takuar me Z. K. por nuk është takuar me asnjërin nga fëmijët e N.K, por më vonë e ka identifikuar H.K. si personin që e ka vizituar N.K. në B.

Përveç kësaj, dëshmitari B. O. (P.) dhe t. L. K, në dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtim gjyqësor përshkruan takimin me F.Ç. dhe çka u kishte thënë ky dëshmitar në lidhje me ngjarjen që kishte ndodhur në stanin në B. në malin M. Kjo bisedë është përshkruar në hollësi në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe ky kolegji nuk sheh asnjë arsye që ta përsërisë atë (aktgjykimi i kundërshtuar, faqe 39-41 dhe 56-67). F.Ç. i tha policit se nuk dëshironte më tutje të jetë dëshmitar sepse në B.të P. e kishte takuar mikun e tij N. K. që ishte me dy djemtë e tij dhe pastaj njërin prej djemve, H, e kishte njohur, që ishte njëri nga personat që i kishte parë te stani dhe që e ka përshkruar si njeriu syshtrembër. Për këtë arsye, togeri K. ka përpiluar një notë zyrtare – memorandum të datës 05 nëntor 2010 (e cila është administruar si provë në shqyrtim gjyqësor) të cilën e ka dërguar në PSRK dhe i është referuar intervistës së F.Ç. të datës 03 nëntor 2010 dhe të dëshmitarit D1. Ai theksoi frikën që e kanë shfaqur F.Ç. dhe dëshmitari D1 për sigurinë e tyre personale dhe kërkoi

që të tjerët të mos dinë se çfarë informata kanë dhënë në polici. Në lidhje me këto fakte, gjykata e shkallës së parë ballafaqoi policin O. me F.Ç. Nga leximi i memorandumit të datës 05 nëntor 2010 mund të vërtetohet se përmbajtja e tij plotësisht përputhet me deklaratën e dëshmitarit D1 të dhënë në fazën e procedurës paraprake, por edhe me provat se prej telefonit mobil të tij me numër 04.....; është bërë thirrja telefonike me I.L.n përmes antenës në B.

#### **B.2.6. Deklarata e dëshmitares M.K.**

Avokati mbrojtës i B.K.t po ashtu e kundërshton deklaratën e dëshmitares M.K. të dhënë në fazën e procedurës hetimore.

Kolegji nuk gjen asnjë shkelje që do ta bënte dëshminë e dëshmitares të papranueshme.

Dëshmitarja M.K. është intervistuar në polici më 27 tetor 2010 ku ka identifikuar personat përmes fotografive. Këtë deklaratë ajo e ka mohuar në shqyrtim gjyqësor të datës 05 tetor 2011 me arsyetimin se policia ia kishte imponuar deklaratën si dhe identifikimin. Megjithatë, në lidhje me këto rrethana nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete e as nuk ka lajmëruar prokurorin as ndonjë person tjetër, kurse nuk është kontestuese se ajo e ka nënshkruar procesverbalin pa asnjë vërejtje. Nga leximi i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, sigurohet se kjo dëshmitare nuk ishte në gjendje të japë sqarime për komunikimet që i kishte bërë përmes SMS mesazheve të dërguara prej telefonit të saj mobil te numri i telefonit të I.L. dhe B.K. Prandaj, kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka arritur në përfundim se dëshmia e saj para gjykatës nuk ishte bindëse dhe ka vendosur ta pranojë deklaratën e saj të dhënë në polici më 27 tetor 2010 si më të besueshme.

Gjykata e Apelit vlerëson se deklarata e M.K.t e dhënë në polici më 27 tetor 2010, është provë e besueshme sepse nuk është vërtetuar se është marrë në kundërshtim të dispozitave të KPPK-së, dhe të dytë, i akuzuari dhe avokati i tij mbrojtës, e kishin mundësinë për ta kundërshtuar dëshmitaren gjatë shqyrtimit gjyqësor.

#### **B.3. Propozimet e palëve për pranueshmërinë e provave dhe aktvendimet e Gjykatës së Qarkut lidhur me këto propozime: Neni 403 (2) i i KPPK-së**

Avokati mbrojtës i të akuzuarit pretendon se prej fillimit të shqyrtimit gjyqësor kanë kërkuar që disa prova në të cilat është bazuar aktakuza duhet të shpallen si të papranueshme, por gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për këto propozime deri në fund të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 154 (1), (2) dhe (5) i KPPK-së thotë:

*“(1) Për pranimin e provës gjykata vendos me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare.*

*(2) Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngrihet nga pala në kohën kur prova paraqitet gjykatës dhe në rast të veçantë në seancën për konfirmimin e aktakuzës. Përfundimisht, mund të ngrihet më vonë, nëse çështjet nuk i janë bërë të njohura palës në kohën kur prova është paraqitur, ose ekzistojnë rrethana të tjera të justifikueshme...*

*(5) Në të gjitha fazat e procedurës gjykata detyrohet të sigurojë që asnjë provë e papranueshme, referencë a dëshmi në provën e tillë të mos përfshihet në shkresa ose të mos paraqitet në shqyrtim gjyqësor a në seancë dëgjimi para shqyrtimit gjyqësor.”*

Gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësor më 29 shkurt 2012 si prova ka administruar provat në vijim: procesverbalin e identifikimit të personit nga pala e dëmtuar A.M., procesverbali i bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit B.K. dhe certifikata për sendet e konfiskuara gjatë kontrollit , provat e telekomunikimeve dhe hartografike, deklaratat e dëshmitarit D-1/M-1 të dhëna në polici, para gjyqtarit të procedurës paraprake të EULEX-it dhe para prokurorit, memorandumit të togerit L.K. lidhur me deklaratën e dëshmitarit F.Ç. deklaratën e dëshmitares M.K. të dhënë në polici. Mbrojtja ka paraqitur vërejtjet e veta kundër këtyre provave. Mirëpo, gjykata e shkallës së parë i ka administruar ato si prova në shqyrtim gjyqësor dhe ka konstatuar se aty nuk ka asnjë provë të papranueshme.

Së pari, dispozitat e cituara më lart tregojnë se gjykata nuk është e obliguar të vendosë kur ngritet çështja e pranueshmërisë së provave apo kur gjykata merret me të *sipas detyrës zyrtare*. Megjithatë, nuk ka dispozitë të saktë që përcakton se kur merret një aktvendim i tillë. Si rregull themelore, dhe kjo mund të konstatohet nga dispozitat që rregullojnë zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe në veçanti procedurën e provave, aktvendimi lëshohet para përfundimit të procedurës së provave me qëllim që palëve t’u jepet përgjigje çfarë do të jetë materiali ligjor i provave që mund të adresohet në fjalën përfundimtare dhe në aktgjykim. Dhe gjykata e shkallës së parë e ka bërë pikërisht këtë..

Së dyti, të gjitha provat në pyetje ishin renditur tanimë në aktakuzë dhe pranueshmëria ishte vlerësuar më herët nga gjyqtari për konfirmim të aktakuzës. Nuk ka asnjë indikacion se lëshimi i aktvendimit në një fazë të mëvonshme do të bënte shkelje të të drejtave të të pandehurve për gjykim të drejtë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen po ashtu se provat e përmendura më lart janë të pranueshme dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë shkelje të dispozitave të procedurës penale kur ka vendosur për pranueshmërinë e këtyre provave.

#### **B.4. Aktakuza dhe ndryshimi i aktakuzës - I.L.**

Avokati mbrojtës i të akuzuarit I.L. bën dy pretendime përkitazi me akuzën kundër të pandehurit. Së pari, ai pohon se akuza nuk përfshin asnjë veprim inkriminues, asnjë përshkrim të veprimeve konkrete të të akuzuarit I.L., që do ta lidhte me veprat e pretenduara penale. Së dyti, kjo lloj mangësie nuk mund të korrigjohet me deklaratën e dhënë nga prokurori gjatë fjalës përfundimtare. Duke u bazuar në nenet 376, 386 (1) dhe 403 (1) 10) të KPPK-së i pandehuri I.L. duhet të lirohet.

Avokati mbrojtës ka të drejtë për të dy pikat.

Përmes aktakuzës së ngritur nga prokurori, të datës 31 mars 2011, i pandehuri I.L. është akuzuar për kryerje të veprës penale të krimit të organizuar në përputhje me nenin 274 (1) të KPK-së , në lidhje me veprën penale të rrëmbimit, në përputhje me nenin 159 (2) të KPK-së, në bashkëkryerje me B.K. D.I. H.K. A.N. H.K.dhe S.G. Gjyqtari për konfirmim e konfirmoi aktakuzën më 20 maj 2011 pa asnjë intervenim nga PSRK-ja për ta plotësuar apo ndryshuar aktakuzën.

Neni 305 (1) 4) i KPPK-së thotë:

*Aktakuza përmban:*

*4) Kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;*

Neni 386 (1) i KPPK-së thotë:

*(1) Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.*

Neni 376 (1) i KPPK-së thotë:

*Kur paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re.*

Rëndësia për paraqitjen e aktakuzës me saktësi (neni 305 (1) 4) i KPPK-së mund të kuptohet më së miri kur merret parasysh se aktgjykimi mund t'i referohet vetëm fakteve që përmban aktakuza (neni 386 (1) i KPPK-së).

Njëri nga gurthemet e gjyqimit të drejtë është që i pandehuri ka të drejtë të informohet për shkakun e akuzës, pra për veprat për të cilat pretendohet se ai/ajo i ka kryer dhe në ciklën prej tyre bazohet aktakuza. Në lëndën konkrete është shumë e qartë se aktakuza fillestare, dispozitivi, nuk përfshijnë asnjë përshkrim të veprave të pretenduara të të pandehurit I.L. që të pretendohet se disa ka marrë pjesë në veprat penale. Emri i tij përmendet vetëm si bashkëkryerës në fillim të aktakuzës, pa referencë të mëtutjeshme se çfarë ishte roli i tij i pretenduar në kryerjen e veprës penale. Kjo dallon nga ajo që pohon prokurori në krahasim me të bashkakuzuarit e tjerë.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit I.L. disa herë pohoi gjatë shqyrtimit para Gjykatës së Qarkut se aktakuzës i mungon përshkrimi konkret i veprimeve për të cilat dyshohet i pandehuri. Prokurori nuk ndërmoi asnjë veprim para fjalës përmblylëse për ta përmirësuar, plotësuar apo ndryshuar aktakuzën. As Gjykata e Qarkut nuk e diskutoi këtë çështje.

Kolegji konsideron se veçmas kur është fjala për akuzat që lidhen me disa të bashkëpandehur, gjendja faktike duhet të përshkruhet në aktakuzë në mënyrë aq të hollësishme sa që secili i pandehur të ketë mundësi të kuptojë cili është veprimi i pretenduar i tij që bën lidhjen mes tij dhe veprës penale. Kolegji konsideron se e tërë kjo mungon sa i përket të pandehurit I.L.. Kjo do të thotë se aktakuza nuk është dashur të konfirmohet pa kërkuar nga prokurori i shtetit se cilat ishin faktet e pretenduara në lidhje me të pandehurin I.L. Kolegji gjen se është bërë shkelje e nenit 305 (1) 4) të KPPK-së.

Aktgjykimi i kundërshtuar tregon se prokurori e ka ndryshuar aktakuzën kur ka dhënë fjalën tij përfundimtare (shih më lart). Në njërin anë është e vërtetë që prokurori mund ta ndryshojë aktakuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në anën tjetër, duhet të merret parasysh e drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e aktakuzës në aspektin e të drejtës së të akuzuarit për përparatjen e mbrojtjes së tij. Kjo do të thotë se kur paraqiten arsye për ndryshimin apo plotësimin e aktakuzës kjo duhet të bëhet pa asnjë vonesë e jo ndryshimi të lihet për fjalën përfundimtare. Përveç kësaj, duke u bazuar në atë çka u tha më lart, në nenin 376 të KPPK-së dhe në parimin e përgjithshëm se gjykimi zhvillohet lirshëm, nëse prokurori dëshiron ta ndryshojë kjo duhet të bëhet në mënyrë eksplicite dhe të qartë.

Kolegji konsideron se ajo çka prokurori pohoi në lidhje me të pandehurin I.L. gjatë fjalës së tij përfundimtare ishte një shprehje e mjegullt e cila nuk mund assesi të konsiderohet si ndryshim apo ndryshim i aktakuzës.

Si përfundim, kolegji gjen se prokurori e ka akuzuar të pandehurin I.L. për kryerje të veprës penale të krimit të organizuar në lidhje me veprën penale të rrëmbimit pa përshkruar asnjë veprim inkriminues që do ta lidhte të pandehurin me veprën e pretenduar penale. Prandaj, kolegji konsideron se ka mungesë konstituive të elementeve të veprës penale të përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Deklaratat e prokurorit të dhëna në fjalën përfundimtare nuk mund të konsiderohen si ndryshim i ligjshëm dhe i pranueshëm i aktakuzës.

Prandaj, veprimi për të cilën akuzohet i pandehuri I.L. nuk përbën asnjë vepër penale. Në përputhje me nenin 390 (1) të KPPK-së i pandehuri I.L. është liruar nga të gjitha akuzat e ngritura në aktakuzë.

Gjykata e Apelit, me marrjen e këtij vendimi në këshillim, ka ndërprerë menjëherë paraburgimin kundër të pandehurit më 15 maj 2014 (shih aktvendimin e Gjykatës së Apelit nr. PAKR 1282/12 të datës 15.05.2014).

Kolegji gjithashtu shënon se në lidhje me lirimin e këtij të pandehuri, pretendimet e mëtutjeshme ankimore nga avokati i tij mbrojtës nuk kanë nevojë të shqyrtohen fare.

#### **B.5. Marrja në pyetje e të pandehurve para prezantimit të të gjitha provave: Neni 403 (1) 9 i KPPK-së**

Avokati mbrojtës i H.K. përmes ankesës së tij pretendon se të pandehurit ishin marrë pyetje në shqyrtim gjyqësor para prezantimit të provave. Edhe pse avokati mbrojtës nuk kishte paraqitur asnjë argument në mbështetje të pretendimit të tij, Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar edhe nga kjo pikëpamje sipas detyrës zyrtare.

Neni 360 (3) i KPPK-së thotë:

*“(3) Prezantimi i provave bëhet sipas rendit të caktuar nga kryetari i trupit gjykues. Në parim, së pari prezantohen provat e propozuara nga paditësi, duke vazhduar me provat e propozuara nga mbrojtësi ose i pandehuri dhe, së fundi, provat të cilat trupi gjykues ka urdhëruar të mblidhen sipas detyrës zyrtare ....”*

Neni 371 (1) i KPPK-së thotë:

*“(1) Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe prezantimit të provave materiale vazhdohet me marrjen në pyetje të të akuzuarit i cili nuk ka pranuar fajësinë ose për të cilin zbatohet,....”*

Neni 403 (1) 9 i KPPK-së thotë:



*“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:*

...

*9) I akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për tërë akuzën ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave .”*

Pas rishikimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se të pandehurit janë marrë në pyetje më 10, 11 dhe 19 janar 2012. Më pastaj, më 24 janar, më 22, 28 dhe 29 shkurt, më 12 mars dhe më 24 prill 2012 janë dëgjuar dëshmitarë të tjerë dhe janë prezantuar prova materiale. Gjykata e Apelit gjen se të pandehurit janë marrë në pyetje para se të dëgjoheshin të gjithë dëshmitarët dhe para prezantimit të tërë provave materiale.

Dispozitat e cituara më lart pasqyrojnë idenë se të pandehurit duhet t’i jepet mundësia për ta mbrojtur veten kundër të gjitha provave të mbledhura nga prokuroria. Ligjbërësit në Kosovë duket se kanë zgjedhur një sistem ku mundësia për mbrojtje efektive sigurohet kur i pandehuri dëgjohet vetëm kur të prezantohet të gjitha provat. Megjithatë, ekzistojnë dispozita të tjera në KPPK të cilat tregojnë se kjo rregull nuk është absolute dhe strikte.

Neni 360 (4) i KPPK-së përcakton se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët dhe i dëmtuari mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja dhe mbledhjen e provave të reja. Neni 374 (1) i KPPK-së përcakton se pas përfundimit të procedurës së provave, kryetari i trupit gjykues i pyet palët dhe të dëmtuarin nëse kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave. Dhe përfundimisht, neni 383 (1) i KPPK-së përcakton se kur pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve, trupi gjykues nuk çmon se duhet marrë prova të tjera, kryetari i trupit gjykues shpall shqyrtimin gjyqësor të përfunduar.

Këto dispozita bazohen në parimin e shprehur në nenin 7 të KPPK-së i cili thekson se gjykata, prokurori publik dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Kolegji i Gjykatës së Apelit konsideron se ky parim së bashku me dispozitat e shtjelluara më lart në mënyrë të qartë tregojnë se është e mundur që të dëgjohen dëshmitarët dhe të merren prova materiale gjithashtu edhe pasi që i pandehuri është marrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rregulli në nenin 403 (1) 9) të KPPK-së patjetër duhet të interpretohet duke pasur parasysh rrethanat procedurale të lëndës në fjalë dhe duke i kushtuar rëndësi çështjes nëse janë shkelur të drejtat e të pandehurit për mbrojtje efektive. Posaçërisht, në lëndët voluminoze nuk është e pazakontë që të paraqitet nevoja për prova të mëtutjeshme apo ridëgjimin e disa dëshmitarëve edhe pas marrjes në pyetje të të pandehurit. Është tërësisht e qartë se në këto lëndë të pandehurit duhet patjetër t’i jepet mundësia që ta jap deklaratën e tij/saj dhe nëse ka nevojë të ftohen dëshmitarët e ri.

Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor mund të vërtetohet se nuk ka pasur kundërshtime të paraqitura kundër kësaj renditje të procedimit të provave. Mbrojtja ka pasur mundësi që

të komentojë provat e prezantuara dhe vetë të pandehurit kanë pasur mundësi që t'i paraqesin mendimet e tyre në lidhje me provat pas administrimit të tyre. Nuk ka asnjë indikacion se të drejtat e mbrojtjes janë shkelur në ndonjë mënyrë përkitazi me këtë çështje. Prandaj, pretendimi në ankesën e avokatit mbrojtës të H.K. është i pabazuar dhe refuzohet.

#### **B.6. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor: Neni 403 ( 2) i KPPK-së**

Avokati mbrojtës i H.K. pretendon se janë shkelur dispozitat e procedurës penale sepse gjykata ka harruar të zbatoj dispozitat e nenin 350 të KPPK-së apo i ka zbatuar gabimisht dhe kjo ka ndikuar apo mund të ketë ndikuar në lëshimin e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Avokati mbrojtës pretendon se procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk është finalizuar asnjëherë pas seancës, nuk është nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi, dhe palët nuk kanë pasur mundësi që ta ushtrojnë të drejtën e tyre për ta kontrolluar procesverbalin final.

Neni 350 (1) dhe (2) i KPPK-së përcakton:

*“(1) Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ...përfundohet me mbarimin e seancës. Ai nënshkruhet nga kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi.*

*(2) Palët kanë të drejtë të kontrollojnë procesverbalin e përfunduar dhe pjesët shtojcë, të bëjnë komente në përmbajtje dhe të kërkojnë korrigjimin e tij.”*

Kolegji i Gjykatës së Apelit thekson se as avokati mbrojtës e as të tjerët nuk kanë kërkuar shikimin e procesverbalit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje as në formë verbale e as me shkrim në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit apo formës së tij. Duhet vërejtur se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare dhe procesverbali është përkthyer në gjuhën angleze, gjë që natyrisht merr kohë. Pretendimi i avokatit mbrojtës se procesverbali nuk është nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi siç obligohen me nenin 350 (1) të KPPK-së është faktikisht jo i saktë sepse secili procesverbal, versioni origjinal në gjuhën angleze, është nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues dhe nga procesmbajtësi pas finalizimit të procesverbalit. Pastaj, procesverbali është përkthyer në gjuhën shqipe.

Prandaj, Gjykata e Apelit gjen se pretendimi i avokatit mbrojtës O.B. nuk qëndron. Duhet vërejtur se avokati mbrojtës nuk ka paraqitur asnjë arsye se si kjo shkelje e pretenduar do të ketë mundur të ndikojë në lëshimin e aktgjykimit të ligjshëm. Pretendimi është tërësisht i pabazuar. Nuk ka asnjë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale përkitazi me këtë çështje.

### **B.7. Pretendimi se aktgjykimi ka tejkalluar aktakuzën: Neni 403 (1) 10) i KPPK-së**

Avokati mbrojtës i H.K.t pretendon se aktgjykimi i apeluar ka tejkalluar aktakuzën lidhur me klientin e tij sepse dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban shprehje më të ashpra sesa ato në aktakuzë dhe se në paragrafin e fundit të faqes gjashtë së aktgjykimit të apeluar thuhet: “është e qartë nga lista e telefonatave se B.M. ishte duke u vëzhguar nga H.K. dhe S.G., kur ka dalë jashtë shtëpisë më 09.10.2010”.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të apeluar, Gjykata e Apelit gjen se në dispozitivin e aktgjykimit nuk është përfshirë asnjë ndryshim i konsiderueshëm i fakteve relevante në dëm të të pandehurit. Më sakët, gjykata e shkallës së parë gjatë paraqitjes së përshkrimit faktik të veprimeve të të akuzuarit H.K. ka prezantuar rrethanat e theksuara gjatë fjalës përfundimtare të Prokurorit me qëllim të përcaktimit sa më të saktë të mundur të veprës penale për të cilën H.K. ishte akuzuar. Kur gjykata ka përshkruar aktin ajo ka përfshirë disa detaje të cilat nuk gjendeshin në aktakuzë që shërbejnë për përcaktim të saktë të veprës. Gjykata e Apelit konsideron se kjo është bërë brenda kornizës së përshkrimit faktik relevant të elementeve të veprës penale të përmbajtura në aktakuzë. Pra, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me aktgjykimin që tejkallon aktakuzën, prandaj nuk ka ndodhur asnjë shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale siç është pretenduar (neni 403 (1)10) i KPPK-së).

### **B.8. Përmbajtja e dispozitivit dhe arsyetimi i aktgjykimit: Neni 403 (1) 12) i KPPK-së)**

Përmbajtja ligjore e aktgjykimit me shkrim është përcaktuar me nenin 396 të KPPK-së. Në lidhje me strukturën formale, aktgjykimi i apeluar i përmbush të gjitha kushtet ligjore. Është fakt se aktgjykimi i apeluar është voluminoz dhe përmban përsëritje të disa pikave, mirëpo kjo nuk e bën aktgjykimin të pakuptueshëm. Në fakt, dispozitivi i aktgjykimit të apeluar në lidhje me të akuzuarit B.K., D.I., H.K., A.N., H.K. dhe S.G., është tërësisht i qartë dhe konkret, dhe aktgjykimi përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet esenciale. Prandaj, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm dhe në të nuk ka asgjë të paqartë. Është dhënë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese për të akuzuarit B.K., D.I., H.K., A.N., H.K. dhe S.G.. Vetitë dhe faktet esenciale të veprave penale janë dhënë për të gjithë së bashku dhe për secilin veç e veç. Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban arsyet e nevojshme faktike dhe ligjore, prandaj nuk ka pasur asnjë shkelje në lidhje me këtë çështje.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në përputhje me dispozitat e nenit 387 të KPPK-së dhe në lidhje me këtë ka paraqitur konstatimet e saj. Prandaj, qëndrimi dhe vlerësimi i saj në lidhje me provat e administruara është mbështetur me paraqitjen e arsyeve të detajuara. Gjithashtu,

mbrojtja e të akuzuarit i është nënshtruar vlerësimit nga gjykata e shkallës së parë dhe secila provë e prezantuar nga ata është vlerësuar në të njëjtën mënyrë sikur provat e tjera në përputhje me dispozitat e nenit 387 të KPPK-së. Gjykata ka theksuar në mënyrë të qartë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara si dhe arsyet për këtë. Nga arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar patjetër duhet vërejtur se gjykata e shkallës së parë ka bërë një studim dhe analizë gjithëpërfshirëse të provave të prezantuara. Posaçërisht, analiza dhe vlerësimi i provave të telefonave (regjistri i thirrjeve, hartat kartografike dhe identifikimi i celularëve) tregojnë një qasje të detajuar e cila ka çuar në gjetje dhe përfundime të besueshme.

Prandaj, kolegji përfundon se dispozitivi në asnjë mënyrë nuk është në mospërputhje me arsyet e aktgjykimit të kundërshtuar dhe se konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë janë arsyetuar në mënyrë të duhur. Në lidhje me këtë nuk ka ndodhur asnjë shkelje procedurale.

Sidoqoftë, kolegji sqaron se vetë gjetjet dhe saktësia e tyre do të analizohen më poshtë nën pjesët e përshtatshme që kanë të bëjnë me pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të ligjit penal.

## **C. Vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike: Neni 402 (1) 3) i KPPK-së**

### **C.1. Qëndrimet e palëve**

Në ankesat e tyre avokatët mbrojtës të të akuzuarve theksojnë se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë në këtë lëndë penale duke shprehur gjerësisht mendimet dhe interpretimet e tyre në lidhje me provat në mënyrën e cila ndryshon nga mënyra e gjykatës së shkallës së parë.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **B.K.** kundërshton vlerësimin e provave: procesverbali i identifikimit të personave nga pala e dëmtuar A.M., identifikimi i bërë nga dëshmitarja M.K., procesverbali i kontrollit së shtëpisë së të akuzuarit B.K., certifikata mbi konfiskimin e sendeve gjatë kontrollit, mbrojtja e të akuzuarit dhe provat në lidhje me alibinë e tij, duke dhënë argumentet e tij në lidhje me faktet se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si të vërtetuar apo pavërtetuar, arsyetimi i dhënë në lidhje me këtë provë dhe përfundimi i lëshuar posaçërisht në lidhje me posedimin e telefonave mobil.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **D.I.** pretendon se gjykata e shkallës së parë ka konsideruar si të besueshme vetëm provat në dobi të palës së dëmtuar, kurse provat të cilat konfirmojnë alibinë e të akuzuarit nuk janë marrë për bazë edhe pse kjo provë dëshmon se ky i akuzuar ishte duke marrë trajtim mjekësor në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë, prej 16/17.09.2010 deri më 04.10.2010.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **H.K.** pohon se gjykata nuk ka vërtetuar me asnjë provë faktin se H.K. ka marrë pjesë në rrëmbimin e A.M, dhe kjo rrethanë mjafton për të arritur në përfundim se aktgjykimi përmban vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Gjendja faktike nuk është vërtetuar asnjëherë plotësisht në aktgjykimin e kundërshtuar. Se gjendja faktike nuk është vërtetuar asnjëherë plotësisht në aktgjykimin e kundërshtuar, është theksuar në ankesë se gjykata asnjëherë nuk ka vërtetuar se ky i akuzuar ka qenë i pranishëm në “stan” (kasolle në mal) ku pretendohet se është mbajtur viktima, se asnjëherë gjatë 40 ditëve ai nuk është përmendur në asnjë komunikim telefonik në mes të akuzuarit dhe familjes së palës së dëmtuar, apo personave të tjerë, dhe nuk është vërtetuar se arma ka ekzistuar, kurse mbrojtja vazhdimisht gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar që alibia e tij të vërtetohet.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **A.N.** pohon se mbledhja e provave nuk është bërë në mënyrë profesionale dhe se në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar nuk ka asnjë provë materiale që dëshmon se A.N. është kryerësi potencial apo bashkëkryerës i veprës penale për të cilën akuzohet, pra përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese të A.N.t nuk janë koherente në lidhje me gjendjen faktike dhe provat në shkresat e lëndës. Ai ka ngritur çështjen në lidhje me kredibilitetin e deklaratave të dëshmitarit D-1, identifikimin e bërë nga A.M. dhe deklaratën e Policisë H. në lidhje me procedurën e identifikimit, identifikimin nga dëshmitari D-1, deklaratat e dëshmitarëve– togerit L.K. dhe policit B. O. lidhur me takimin e tyre me F. Ç. dhe kundërthëniet në mes të këtyre deklaratave, për të cilat mbrojtja vazhdimisht ka kërkuar që të shpallen prova të papranueshme, dhe dështimi për të vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit dhe provat në lidhje me alibinë e tij.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **H.K.** pohon se të gjitha shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale (të cilat janë theksuar më lart në kapitullin e shkeljeve substanciale të procedurës penale) kanë rezultuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që asnjë provë nuk ka vërtetuar (përtej çdo dyshimi të bazuar) se i akuzuari H.K. ka qenë i implikuar në ngjarjen kritike. Pra, ai i referohet procedurës së identifikimit të personave nga A.M., deklaratave të palës së dëmtuar A.M. të dhëna në Prokurori më 03.11.2010 dhe 05.01.2011, pastaj, mbrojtja e akuzuarit lidhur me atë se ka njohur të akuzuarit B.K, A.N. dhe I.L, rreth kohës që ka qëndruar në malet e I, posedimin e telefonit 04.... dhe provat në lidhje me alibinë e tij dhe mendimin e ekspertit të kartografisë.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **S.G.** pohon se faktet më të rëndësishme të paraqitura nga mbrojtja si prova materiale janë vlerësuar gabimisht nga gjykata. Në arsyetimin e kësaj baze të ankesës, ai i referohet vlerësimit të provave materiale si transkripti i bisedave telefonike, regjistrin të thirrjeve telefonike, procesverbalit të identifikimit dhe vlerësimit të këtyre provave nga gjykata, duke pretenduar se ky vlerësim është tërësisht i gabuar dhe pa argumente.

Avokati mbrojtës për të pandehurin **I.L.** gjithashtu pohon se gjykata e shkallës së parë ka bazuar vendimin e saj në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Prokurori i Apelit i Shtetit është përgjigjur duke theksuar se gjykata ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike.

## C.2. Vlerësimi i kolegjit

Para vlerësimit të meritave të argumenteve të paraqitura nga palët, kolegji konsideron të domosdoshme që të sqaroj standardin e shqyrtimit të ankesave në lidhje me gjetjet faktike të trupit gjykues. Neni 405 i KPPK-së e definon termin “vërtetim i gabuar i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”. Nga këto definicione është e qartë se nuk është e mjaftueshme që ankuesi të demonstrojë vetëm pretendimin e gabimit të faktit apo vërtetimin jo të plotë të faktit nga trupi gjykues. Më saktësisht, kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabuar apo jo i plotë të ketë të bëjë me “faktin material”, ankuesi gjithashtu duhet të vërtetojë se vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike në të vërtetë ka të bëjë me faktin material, p.sh. është jetike për aktgjykimin e lëshuar.<sup>3</sup> Rrjedhimisht, vetëm në raste të tilla ankesa e përmbys vendimin e trupit gjykues mbi bazën faktike.<sup>4</sup>

Siç është shqyrtuar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës së Apelit,<sup>5</sup> është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër t’i jap margjinën e ndryshimit gjetjeve të fakteve nga trupi gjykues sepse trupi gjykues është në pozitën më të mirë që të vlerësojë provat. Gjykata Supreme e Kosovës shpeshherë ka konstatuar se patjetër duhet t’i “nënshtrohet vlerësimit të trupit gjykues mbi besueshmërinë e dëshmitarëve të cilët janë paraqitur personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme për Gjykatën Supreme të Kosovës që të refuzojë vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e atyre dëshmitarëve përveç nëse ekziston bazë e shëndoshë për një gjë të tillë.” Standardi të cilin Gjykata Supreme e ka zbatuar ka qenë “që mos të trazohen gjetjet e trupit gjykues përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të mund të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktit, apo kur vlerësimi i tyre ka qenë tërësisht i gabuar” (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012 30). Qasja e Gjykatës Supreme reflekton parimin e procedurës së apelit i cili zbatohet – edhe pse me disa ndryshime– në të dy juridiksionet të së drejtës

<sup>3</sup> Shih gjithashtu B. Petric, në: Komentaret e neneve të Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë , botimi i 2-të 1986, neni 366 (3).

<sup>4</sup> Shih për të njëjtin qëndrim p.sh. Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nr. PAKR 1122/12 të datës 25.04.2013, par. 39.

<sup>5</sup> Ibid, par. 40.

zakonore dhe të drejtës civile si dhe në procedurat penale ndërkombëtare (*shih p.sh. Gjykata Supreme e Irlandës, Hay kundër O'Grady, [1992] IR 210; Gjykata Federale e Drejtësisë në Gjermani, BGHSt10, 208 (210); Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, Prokurori kundër Kupreskić et al., IT-95-16-A, Aktgjykimi mbi ankesë, par. 28 et seq.*).

Nga shkresat e lëndës rezulton si e pakontestueshme se më 21 shtator 2010 në ora 06.05 në fshatin G, Komuna e K, pala e dëmtuar A.M. është rrëmbyer. Nga deklarata e palës së dëmtuar e dhënë gjatë procedurës hetimore, por gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka vërtetuar kohën, lokacionin dhe mënyrën se si ka ndodhë rrëmbimi. Në lidhje me këtë ngjarje, pala e dëmtuar ka bërë identifikimin e personave në polici, fillimisht përmes fotografive dhe pastaj edhe drejtpërdrejtë. Kjo procedurë (e identifikimit) kryesisht është kundërshtuar nga avokatët mbrojtës të të akuzuarave në ankesat e tyre. Gjykata e Apelit nuk do të ndalet përsëri në çështjen e identifikimit të personave nga pala e dëmtuar A.M. sepse më lartë ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me këtë procedurë dhe nuk ka nevojë që ato të përsëriten. Por, duke pasur parasysh vlerën e ulët provuese të kësaj provë (që është vlerësuar si e tillë gjithashtu edhe nga gjykata e shkallës së parë-aktgjykimi i apeluar, faqe 177), patjetër duhet theksuar se kjo nuk ka qenë prova e vetme e cila ka pasur të bëjë me atë se kush ka qenë i përfshirë në këtë vepër penale. Vlen të përmendet se të gjithë të akuzuarit kanë mohuar të kenë qenë të përfshirë në çfarëdo mënyrë në rrëmbim.

Lidhur me të akuzuarin B.K., përveç që është identifikuar nga pala e dëmtuar A.M. si personi të cilin e kishte parë më 22 shtator 2010 në “stan” në B. (kasollen e malit) në makinën e llojit karavan dhe i cili i kishte thënë se do të kërkonte pagesë për lirimin e tij dhe i cili e kishte pyetur nëse Tito kishte qenë njeri i mirë, pjesëmarrja e këtij të akuzuari në rrëmbimin e palës së dëmtuar bazohet në prova të tjera të vlerësuara gjithashtu edhe nga gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e kundërshtuar. Nga sendet e konfiskuara në vendbanimin e B.K. gjatë kontrollit, është vërtetuar se ky i akuzuar kishte mbajtur SIM kartela të ndryshme dhe disa telefona mobil dhe se i ndërronte SIM kartelat përmes telefonave mobil të ndryshëm (SIM kartelat me nr. 04../..., 04../..., 04../..., 04../..., 04../..., 04../..., 04../..., 04../... dhe 04../...). Dëshmia e dëshmitares M.K. gjatë procedurës hetimore ka vërtetuar lidhjen e të akuzuarit B.K. dhe disa nga numrat e telefonit që gjithashtu është vërtetuar me regjistrin e marrë nga operatorët e IPKO dhe Vala. Lidhur me kredibilitetin e deklaratave të kësaj dëshmitare dhe identifikimin, Gjykata e Apelit i referohet arsyetimit të dhënë në herët. Nga provat e telekomunikimit, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se ky i akuzuar në mes 20 dhe 23 shtatorit 2010 ka qenë në kontakt të rregullt telefonik me të akuzuarit tjerë, pra ai më 21 shtator 2010 ka komunikuar me D.I, H.K. dhe S.G. Më 22 shtator 2010, ai ka komunikuar me D.I, I.L, H.K. dhe S.G. dhe më 23 shtator 2010 ai ka komunikuar me S.G. Më 20 shtator 2010, prej orës 05.10 dhe 06.51, duke përdorë SIM kartelën 04../..., B.K. ka komunikuar me D.I. dhe ky telefon ka

aktivizuar antenën në zonën e kodit mobil të Gj. Më 21 shtator 2010, në mes orës 06.15 dhe 07.48, SIM kartela në posedim të B.K.t ka aktivizuar antenat në D, K, D, G, L, B, S dhe D që vërteton se i akuzuari B.K. në atë kohë ka qenë duke udhëtuar në mes të G dhe D. Gjykata e shkallës së parë i ka kushtuar rëndësi të veçantë telefonit mobil NOKIA 6300 me numrin IMEI 1.....0, i cili mbante SIM kartelën me numër 1.....5 dhe në të ishin ri-regjistruar numrat e tre vëllezërve të B.K. Është fakt që është vërtetuar se me të njëjtin numër IMEI ekzistojnë shumë telefona të klonuar mobil, mirëpo nga provat e telekomunikimit është vërtetuar se SIK kartela me numër 04./ .... ishte vendosur në telefonin me të njëjtin numër IMEI dhe se ai numër është përdorë për të bërë kërkesa për pagesë te djali i A.M. Këto prova janë shumë bindëse. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë i referohet bisedës telefonike në mes I.L.dhe A.M. (ora 22.00, 10 dhjetor 2010) në të cilën I.L. i referohet pjesëmarrjes së B.K.t në konfliktin e armatosur me policinë natën paraprake. Kjo bisedë telefonike korrespondon me ngjarjen e cila ka ndodhë në ora 00.30 më 10 dhjetor 2010, kur B.M. kishte dërguar haraçin në lokacionin e caktuar nga rrëmbyesit, por që është kapur nga policia dhe me këtë rast kishte pasur shkëmbim të zjarrit me rrëmbyesit. Në bazë të fakteve më lartë, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar si të pabazuar mbrojtjen e të akuzuarit në lidhje me alibinë e tij, se në kohën kontestuese ai nuk ishte në Kosovë, se gjendej në Shqipëri, se më 06 shtator 2010 ai kishte qenë në shtëpinë e dëshmitarit A.K. për t'i shprehur ngushëllime për vdekjen e vëllait të tij dhe më 09 shtator 2010 ai ishte i pranishëm në të pame dhe ceremoninë fetare prej orës 14.50 deri më 22.30 dhe se deri në orën 03.00 ai kishte qenë së bashku me dëshmitarin Jusuf (Ramë) Krasniqi. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar nuk e përjashton mundësinë se ky i akuzuar ishte larguar nga Kosova rreth datës 15 shtator 2010, mirëpo nga provat më lartë është vërtetuar se më 09 shtator 2010 i akuzuari B.K. ka qenë në posedim të telefonit mobil me numër 04./....., dhe se nga të dhënat e kartografisë është vërtetuar se në mes orës 21.00 dhe 22.00 më 09 shtator 2010 personi i cili ka mbajtur këtë telefon ishte duke udhëtuar veri-jug në një zonë 10 km nga T. dhe se ka qenë në zonën e njëjtë prej orës 22.00 deri në 23.00. Kurse të dhënat nga regjistri tregojnë se në periudhën në mes orës 21.00 dhe 22.00 në këtë datë së paku 20 SMS mesazhe janë shkëmbyer në mes të personit i cili ka mbajtur këtë telefon dhe dëshmitarit B.M. Prandaj, Gjykata e Apelit gjithashtu gjen se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vlerësimin e dëshmimeve të dëshmitarëve A.K, J. R. K, dhe D. R. janë të sakta. Kolegji pajtohet me trupin gjykues se këta dëshmitarë kanë dëshmuar me qëllim që t'i sigurojnë alibitë për të akuzuarit dhe kështu të garantojnë mbrojtjen për ta; kolegji nuk i konsideron të besueshme. Kolegji gjithashtu nuk e konsideron të nevojshme që më tutje të merren në pyetje dëshmitarët lidhur me alibinë, kjo çështje tashmë është sqaruar.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar pjesëmarrjen e të akuzuarit D.I. në kryerjen e kësaj vepre penale nga identifikimi i bërë nga pala e dëmtuar A.M. i cili përshkruar këtë të akuzuar si personin i cili më 04 tetor 2010 e kishte xhiruar atë me video si “shenjë se ai ishte ende gjallë”. Por, përveç



kësaj prove fakti se D.I. ka qenë në Kosovë gjatë kohës diskutabile gjithashtu është vërtetuar me regjistrin e telefonatave. Fillimisht, gjykata nga dëshmia e dëshmitarit Rr.I, ka vërtetuar faktin se ky dëshmitar kishte pasur në posedim telefonin me numër IMEI 3.....6, i cili ishte lënë në shtëpi nga vëllai i tij D.I., kurse provat e telefonit dëshmojnë se në telefonin mobil me këtë IMEI janë përdorë SIM kartelat me numrat: 04../....., 04../....., 04../....., që e vërteton faktin se ky i akuzuar ka komunikuar me B.K.n më 20 shtator në mes orës 05.10-06.51 dhe se telefoni në posedim të D.I. kishte aktivizuar antenat në D, P. dhe B, që do të thotë se ai ishte duke udhëtuar. Gjithashtu, nga regjistri i thirrjeve telefonike nuk janë ri-regjistruar thirrje tjera në mëngjesin e hershëm, por biseda e tij me të akuzuarin B.më 21 shtator 2010 në ora 09.59 ishte ri-regjistruar dhe se ata ishin në komunikim të vazhdueshëm me SMS mesazhe kur janë aktivizuar antenat brenda trekëndëshit të ashtuquajtur (sqarimi i dhënë më lartë). Nga arsyet e përmendura më lartë, kjo gjykatë ka gjetur se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve që përfshijnë këtë të akuzuar në kryerjen e veprën penale konkrete janë të sakta dhe të bazuara dhe si të tilla aprovohen në tërësi.

Nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit të apeluar rezulton se H.K. është identifikuar nga pala e dëmtuar A.M. si njëri nga personat i cili e kishte ruajtur atë në “stanin” në B. dhe se kur ai ishte larguar nga aty më 21 dhe 22 shtator 2010, si personin i cili kishte mbajtur pushkë automatike. Gjithashtu, dëshmitari D-1 (deklaratat e tij të dhëna në procedurën hetimore) e kishte identifikuar këtë të akuzuar përmes fotografive, si personin i cili kishte qenë i pranishëm në “stanin” në B. Nga deklarata e policit B. O. dhe togerit L.K, përkatësisht memorandumit i shkruar më 05 nëntor 2010, faktet e paraqitura nga dëshmitari D-1 dhe dëshmitari F.Ç. janë konfirmuar në lidhje me të akuzuarin H.K.n dhe posaçërisht fakti se ky i fundit ka refuzuar bashkëpunimin me policinë dhe prokurorinë kur ka bërë të ditur se personi syshtrëmbër është H.K, i biri i personit të cilin e kishte njohur për mbi 30 vite (në lidhje me këtë deklaratë shih paragrafin B.2.4 të këtij aktgjykimi). Dëshmitari D-1/M-1 në intervistën e tij të dhënë në polici më 09.11.2010 ka deklaruar se në “stanin” në B. ai i kishte parë tre persona prej të cilëve njëri kishte pushkë automatike dhe pasi e përshkruan se si dukej dhe si ishte veshur si karakteristikë përshkruan pamjen “me shikimin me sy pak të shtrembër”, prandaj, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë i lëshuar nga krahasimi i këtyre deklaratave është i saktë dhe logjik. Prandaj, pretendimet e avokatit mbrojtës për këtë të akuzuar janë të pabazuara.

Gjithashtu, nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit të apeluar rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar përtej çdo dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari A.N. ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale rrëmbim i A.M. Prandaj, A.M. e ka identifikuar atë përmes fotografive (me 70% siguri) se ky është personi i cili në “stanin” në B. e kishte pyetur atë lidhur me E.H. Mirëpo, përveç kësaj prove gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit gjithashtu i referohet dëshmisë së dëshmitarit D-1 (të dhënë në procedurën hetimore në polici dhe në prokurori), dëshmi e cila pakontestueshëm

konfirmon se A.N. është personi të cilin e kishte parë më 22 shtator 2010 në “stanin” në B. si vozitësi i makinës Toyota 4 Runner me xham të errët dhe të cilit ia kishte dhënë telefonin e tij personal për të bërë thirrje. Këto fakte gjithashtu janë vërtetuar edhe me dëshmitë e p. B.O. dhe t. L.K. në lidhje me rrethanat e tyre nga F.Ç. Këto fakte janë vërtetuar nga të dhënat e regjistrit të thirrjeve telefonike të bëra nga telefoni mobil në posedim të dëshmitarit D-1-04../..... Veçanërisht, më 22 shtator 2010 në ora 11.31, numri i I.L.t 04../.... (të cilin ai e kishte në posedim), ka pranuar një thirrje nga telefoni i dëshmitarit D-1, e cila plotësisht vërteton deklaratën e dëshmitarit D-1 të dhënë gjatë procedurës hetimore dhe deklaratave të policëve në lidhje me atë se çfarë ju kishte thënë dëshmitari F. Ç. Në bazë të këtyre fakteve, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i akuzuari A.N. ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale rrëmbim i palës së dëmtuar A.M., kurse provat e propozuara nga A.N. për të vërtetuar alibinë nuk janë konsideruar të besueshme. Përfundimi i bërë nga gjykata e shkallës së parë aprovohet nga Gjykata e Apelit si të sakta dhe të bazuara.

Lidhur me të akuzuarin H.K., gjykata e shkallës së parë ka bazuar gjetjet e saj se ky i akuzuar ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale në deklaratën e A.M. i cili në deklaratën e tij të datës 30 dhjetor 2010 ka identifikuar këtë të akuzuar si njërin nga personat e pranishëm gjatë xhirimit të tij dhe i cili ishte i prezantuar si A. nga M. Këto fakte janë lidhur nga gjykata e shkallës së parë me të dhënat e regjistrit të thirrjeve telefonike që vërtetojnë se më 04 tetor 2010 ky i akuzuar nuk ka pasur asnjë komunikim me telefon në mes orës 15.35 dhe 19.33 me asnjërin nga telefonat e atribuar atij dhe për të cilët janë ofruar të dhëna që janë lidhur me periudhën e heshtjes së telefonave të atribuar D.I. Nga deklarata e të akuzuarit H.K., është vërtetuar se ai ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të numrit të telefonit 04../ .... me të cilin kishte kontaktuar B.K. Më 20 shtator 2010, kjo thirrje kishte aktivizuar antenën afër “stanit” në B. Prandaj, është logjike siç është gjetur nga gjykata e shkallës së parë se ky i akuzuar në këtë datë ishte në “stanin” në B. për të përgatitur vendosjen e A.M. Gjithashtu nga regjistri i thirrjeve telefonike është vërtetuar komunikimi i rregullt i të akuzuarit H.K. me të akuzuarin B.K., por gjithashtu kishte pasur edhe komunikim të mëvonshëm dhe telefoni i të akuzuarit H. kishte aktivizuar antenën në zonën e kodit mobil në Pejë. Gjykata e shkallës së parë i gjithashtu i referohet komunikimeve të këtij të akuzuari më 22 shtator 2010 me B.K. dhe S.G.n dhe heshtja e telefonave mobil në posedim dhe shfrytëzim të B.K, A.N. dhe I.L. dhe kjo heshtje korrespondon me kohën kur A.M. është dërguar në mal. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit H.K dhe ka vërejtur se kundërthëniet në deklaratën e tij në lidhje me kohën kur ai pohon se ka qenë në malet I. dhe Z. me J.K, I. dhe D., për të ndërtuar një “stan”. Lidhur me këtë pretendim të të akuzuarit këta persona janë dëgjuar si dëshmitarë. Mirëpo, besueshmëria e deklaratave të të akuzuarve është zhvlerësuar duke krahasuar pohimin e tij (i akuzuari H.) se puna në mal përfshinte rregullimin e kulmit të “stanit” me xhaxhain e tij dhe puna në “stan” kishte të bëjë me rrënimin e shtëpisë ekzistuese dhe pastaj ndërtimin e një të re. Gjithashtu është vlerësuar

edhe foto dokumentacioni dhe video xhirimi i prezantuar nga avokati mbrojtës i të akuzuarit për të vërtetuar kredibilitetin e pretendimin të të akuzuarit si ai kishte qenë në mal në kohën në fjalë, dhe lidhur me këtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë se duke pasur parasysh kohën dhe fazën e hetimit për këtë të akuzuar, ato xhirimi kanë qenë të qëllimshme për të krijuar alibinë për të akuzuarin. Prandaj, në bazë të fakteve të lartpërmendura, Gjykata e Apelit gjen se gjetjet dhe vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë janë të sakta dhe të bazuara dhe të njëjtat i aprovon në tërësi, kurse pretendimet ankimore të avokatit mbrojtës janë të pabazuara.

Lidhur me të akuzuarin S.G., gjykata e shkallës së parë nga pretendimi i të akuzuarit ka gjetur se ky i akuzuar ka pasur në posedim dhe ka shfrytëzuar numrin e telefonit 04../..... Në bazë të të dhënave të paraqitura në regjistrin e thirrjeve telefonike, gjykata ka gjetur se SIM kartela me numër 04../..... ishte vendosur në telefonin mobil me numër të IMEI 3.....0. Edhe pse ky i akuzuar ka mohuar ta ketë shfrytëzuar numrin e telefonit 04../....., nga kjo provë (në regjistrin e thirrjeve telefonike) është vërtetuar se kjo SIM kartelë ishte vendosur në telefononin me të njëjtin numër IMEI. Edhe pse i akuzuari S.G. kishte mohuar t'i ketë përdorur numrin e telefonit 04../....., gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se ai gjithashtu ka përdorë edhe këtë numër sepse kartela ishte vendosur në telefonin me numër IMEI 3.....0 dhe ky ishte telefoni i njëjtë në të cilin kartelat me numrat e lartpërmendur ishin vendosur (04../..... dhe 04../.....), dhe të cilët ai i kishte përdorë vetëm për 10 ditë. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar nga komunikimi përmes telefonit se S.G. kishte pasur komunikim të rregullt me të akuzuarin B.K. më 21, 22 dhe 23 shtator 2010 dhe se telefoni i tij kishte aktivizuar antenën në kodin mobil në G. Gjithashtu, nga të dhënat e regjistrin të thirrjeve telefonike është vërtetuar se telefonat në posedim të të akuzuarit B.K. dhe telefoni mobil në posedim të S.G.t kanë aktivizuar antenën në L. (06.40, 06.41 dhe 06.43), në S. (06.58 dhe 06.59 dhe në D. (07.00 dhe 07.08) dhe nga këto prova është konstatuar se ata kanë udhëtuar së bashku në drejtim të njëjtë. Në të njëjtën mënyrë, gjykata e shkallës së parë duke iu referuar të dhënave nga transkripti i telefonave dhe aktivizimit të antenave përkatëse, veçanërisht në G, ka gjetur se më 09 tetor 2010 ky i akuzuar dhe i akuzuari H.K. kanë qenë në G. dhe si përfundim logjik ata ishin duke përcjellë dhe vëzhguar B.M. i cili kishte shkuar për ta paguar haraçin. Prandaj, Gjykata e Apelit aprovon vlerësimin dhe gjetjet e gjykatës së shkallës së parë dhe në bazë të gjithë këtyre fakteve gjen se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Lidhur me të akuzuarin I.L, Gjykata e Apelit nuk ka nevojë të merret me shqyrtimin e fakteve të vlerësuara dhe vërtetuara nga trupi gjykues, sepse Gjykata e Apelit tashmë ka shpallur (shih më lart) të pandehurin të pafajshëm sepse akti për të cilin i pandehuri I.L. është akuzuar nuk përbën asnjë vepër penale, dhe prandaj i pandehuri I.L. është liruar nga të gjitha akuzat.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar të gjitha provat e analizuara nga trupi gjykues dhe me kujdes ka marrë parasysh vlerësimin e trupit gjykues në aktgjykimin e apeluar. Objektiviteti i 'provave të telefonit' është mu në zemrën e këtij vlerësimi. Duke u pajtuar me gjykatën e shkallës së parë, gjithashtu edhe Gjykata e Apelit i jep vlerë të lartë provuesë kësaj prove dhe gjetjeve të bazuara mbi këtë provë.

Siç është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, ekzistojnë kundërthënie në mes të deklaratave të disa dëshmitarëve (D-1, M.K.t, F.Ç.) të dhëna në fazën e hetimeve dhe në shqyrtim gjyqësor. Siç ndodh shpeshherë, dëshmitarët kanë prirje që t'i mohojnë deklaratat e tyre të mëparshme. Kjo çështje tashmë është adresuar nga gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë arsye që të devijojë nga ky vlerësim. Nuk është paraqitur asgjë që do t'i jepte arsye Gjykatës së Apelit që të pranojë prova të reja apo t'i përsëris ato që tashmë janë marrë. Të gjitha provat e paraqitura gjatë gjykimit mbështesin përfundimin logjik dhe bindës lidhur me ngjarjet kritike dhe rrethanat të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë. Nuk ekziston asgjë në ankesa që mund ta kundërshtoj gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë. Prandaj, Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me arsyetimin e aktgjykimin të kundërshtuar (me përjashtim të I.L. siç është cekur më lart) sa i përket gjetjeve faktike dhe konstaton se nuk ka vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike siç është pretenduar në ankesa.

### **C.3. Përfundim**

Nga të gjitha rrethanat e lartpërmendura rezulton se të akuzuarit B.K., D.I, H.K., A.N., H.K. dhe S.G. fillimisht janë përgatitur për rrëmbimin e A.M, se qëllimi i tyre ishte përfitimi financiar (haraçi/shpërbleja nga anëtarët e familjes së A.M.), se kanë pasur dashje dhe veprim të përbashkët për të ndërmarrë veprime inkriminuese. Pra, është përfundim i saktë se të akuzuarit janë bashkëkryerës, sepse pasojat e veprimeve të tyre inkriminuese janë produkt i qëllimit të tyre të përbashkët. Sa secili i akuzuar ka vepruar pjesë e veprimeve inkriminuese mund dhe duhet gjithashtu të ketë ndikim në dënime.

## **D. Shkeljet e pretenduara të ligjit penal**

### **D.1. Cilësimi juridik i veprës penale**

Të gjithë avokatët mbrojtës të të akuzuarve pretendojnë se është shkelur ligji penal në dëm të klientëve të tyre nga vetë fakti se të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprën penale Krim i organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së, në lidhje me veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159(2) të KPK-së. Për më tepër, avokati mbrojtës i të akuzuarit B.K. pretendon se dispozita e nenit 274 (7) 3) të KPK-së gjithashtu është shkelur sepse elementi cilësues sipas nenit 159 (2) të KPK-së nuk e bën veprën krim të rëndë, për shkak të dënimit minimal të përshkruar me ligj për këtë vepër penale. Ai, gjithashtu pretendon se është

shkelur ligji penal në dëm të klientit të tij në shkelje të parimit *in dubio pro reo* sepse nuk është vërtetuar se B.M. ka paguar paratë për lirimin e babait të tij.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit I.L. pohon se me shpalljen e klientin të tij fajtor është shkelur ligji penal në dëm të I.L. sepse nuk ka ekzistuar asnjë akuzë në lidhje me të në këtë rast. Mbrojtësi ka të drejtë në lidhje me këtë dhe kolegji tashmë ka shqyrtuar këtë çështje dhe e ka liruar këtë të akuzuar. Kolegji i referohet arsyetimit të tij të lartpërmendur.

Pretendimet e avokatëve mbrojtës për të akuzuarit B.K., D.I., H.K., A.N., H.K., dhe S.G. janë pjesërisht të bazuara.

Kolegji konsideron se dyshimet e ngritura në lidhje me cilësimin juridik janë relevante. Kolegji i apelit patjetër duhet të analizojë nëse gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në të vërtetë mundëson cilësimin e Krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së.

Si vërejtje paraprake, kolegji vëren se arsyetimi në lidhje me cilësimin në aktgjykimin e kundërshtuar është i pamjaftueshëm dhe nuk shtjellon në detaje elementet e veprës penale (shih. f. 188 të aktgjykimit të kundërshtuar).

Neni 274 (1) i KPK-së përcakton:

*“Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.”*

Përveç kësaj, në paragrafin (7) të këtij neni shtjellohen elementet konstituive të kësaj vepre duke theksuar se për qëllime të këtij neni:

*“1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfutur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.*

*2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.*

*3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet.*

*4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave*

*i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.”*

Së pari, Gjykata e Apelit thekson se gjykata e shkallës së parë ka gjetur si të vërtetuar se të gjitha elementet e veprës penale bazë të Rrëmbimit janë përmbushur në lidhje me të gjithë të pandehurit.

Lidhur me veprën penal Rrëmbim, Gjykata e Apelit konsideron se pretendimi në ankesën e avokatit mbrojtës të pandehurit B.K. se asnjëherë nuk është vërtetuar se B.M. i ka paguar paratë para lirimit të babait të tij nuk është esencial për cilësimin. Informatat nga transkripti i telekomunikacionit padyshim vërteton se qëllimi i të akuzuarit ka qenë përfitimi material. Prandaj, është jo relevante nëse paratë kanë ndërruar duart; kjo nuk është parakusht që vepra penale të ekzistoj. Është e mjaftueshme të konstatohet se kryerësi ka rrëmbyer një personin për ta detyruar personin tjetër që të paguaj para dhe kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur në këtë rast.

Për më tepër, forma e rënduar e veprës penale sipas nenit 159 (2) të KPK-së ekziston kur kryerësi kryen veprën penale si pjesëtar i një grupi, gjë që është vërtetuar në këtë rast.

Qëllimi i të akuzuarit për pagesën e haraçit për palën e dëmtuar është provuar nga kërkesa e B.K.t e datës 26 shtator 2010, në ora 7:21 pas dite, përmes numrit të telefonit 04./....., duke përdorë telefonin Nokia 6300 me numër IMEI 1.....0 (i cili është konfiskuar gjatë kontrollit së vendbanimit të B.K.t), te djali i A.M., B.M, për pagesën e haraçit, me përmbajtjen në vijim: “...Nëse mendon se duhet të arrijmë një marrëveshje, nevojiten 3 milion për lirimin e babait tuaj. Çdo gabim do të kushtojë...”, dhe ai ka prezantuar vetën si “M”. Komunikimi në mes tyre për pagesën e haraçit ka ndodhë në mes të 25 shtatorit 2010 dhe 9 tetorit 2010. Pastaj, më 9 tetor 2010, rreth orës 22:00, është përpjekur të bëhet dorëzimi i parave sipas udhëzimeve të dhëna me telefon (SMS-ve) nga i akuzuari B.K. B.M. ka vepruar sipas atyre udhëzimeve dhe ka hedhur çantën me para në vendin e specifikuar, mirëpo në momentin kur rrëmbyesit kanë tentuar që ta marrin çantën, policia ka intervenuar për t'i arrestuar rrëmbyesit, në këtë mënyrë duke parandaluar përpjekjet e tyre. Paratë i janë kthyer B.M. Është fakt se në shqyrtimin gjyqësor B.M. nuk ka thënë asgjë lidhur me dhënien e parave dhe lirimin e babait të tij. Sidoqoftë, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se më 30 tetor 2010 B. M. ka tërheq shumën prej 300.000 € nga Banka NLB. Në të njëjtën ditë, gjatë mbrëmjes, A.M. është liruar. Më 1 tetor 2010, B. M. ka kthyer shumën prej 70.000 € në të njëjtën bankë.

Në këtë lëndë nuk ka asnjë dilemë se i akuzuari duke vepruar si pjesëtar i grupit, ka rrëmbyer A.M. me qëllim që të detyrojë anëtarët e familjes së tij që të paguajnë një shumë të parave duke kërcënuar me vrasjen e personit të rrëmbyer nëse familja nuk përmbush

kërkesat e tyre. Gjykata e Apelit thekson se dispozita e nenit 159 të KPK-së nuk e përcakton kushtin që haraçi duhet patjetër të paguhet. Ajo që është e nevojshme është dashja për ta detyruar dikë që të veprojë apo mos veprojë nga një akt apo pranimi në heshtje i aktit. Nga kjo rrjedh se gjendja faktike nuk ka mbetur e dyshimtë në asnjë aspekt dhe se nuk ka hapësirë për zbatimin e parimit *in dubio pro reo*. Ky parim zbatohet kur ekziston dyshimi lidhur me faktet, mirëpo në këtë rast një dyshim i tillë nuk ka ekzistuar.

Së dyti. Gjykata e Apelit konsideron se në këtë lëndë dënimi për veprën penale Rrëmbim (neni 159 (2) i KPK-së) është me burgim prej 1 deri 10 vite. Prandaj, Gjykata e Apelit konsideron se termi “së paku” duhet të interpretohet në kuptim që dënimi mund të shqiptohet për atë periudhë kohore, dhe jo si minimumi i dënimit të përcaktuar. Kjo është gjithashtu në përputhje me jurisprudencën e gjykatave më të larta në Kosovë.

Së treti, Gjykata e Apelit konsideron se në këtë lëndë elementi i “grupit të strukturuar” nuk është vërtetuar me gjetjen e fakteve në aktgjykimin e apeluar. Në fakt, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se grupi është formuar për të rrëmbyer A.M. (f. 188 e aktgjykimit të apeluar). Edhe pse të pandehurit kanë pasur role të ndara në rrëmbimin e A.M, ato role ishin të kufizuara në atë vepër dhe jo në grupin në përgjithësi (prandaj duke mos mbështetur nocionin e grupit të strukturuar). Gjykata e Apelit gjen se nuk ka pasur asnjë provë e cila do të demonstronte se kryerësit (të pandehurit) kanë formuar grupin strukturuar në kuptim të nenit 274 (7) 4) të KPK-së, edhe pse kryerësit kanë vepruar në grup. Në fakt, nuk ekziston asnjë provë që sugjeron se grupi ka pasur çfarëdo lloji të strukturës së formalizuar apo që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të kësaj veprë penale. Sidoqoftë, edhe pse të akuzuarit nuk kanë vepruar si grupi i strukturuar i organizuar, gjetjet faktike të gjykatës se shkallës së parë dhe nga ajo cka u tha me lartë, shpënë në konkluzionin se të pandehurit B.K, D.I, H.K, A.N, H.K. dhe S.G. bashkarisht kanë kryer veprimet e pershkuara si në dispozitivin e aktygjykimit të kundërshtuar.

Në bazë të kësaj, Gjykata e Apelit konsideron se kjo lëndë penale nuk përmban elemente të veprës penale Krim i organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së, siç është gjetur nga gjykata e shkallës së parë. Sidoqoftë, veprimet inkriminuese të të akuzuarve B.K, D.I, H.K, A.N, H.K. dhe S.G. përmbajnë të gjitha elementet esenciale të veprës penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Sipas nenit 386 (2) të KPPK-së “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.”

Duke pasur parasysh faktet e paraqitura më lart, Gjykata e Apelit gjen ligji është zbatuar gabimisht në dëm të të akuzuarve, siç është nënvizuar me të drejtë nga avokatët mbrojtës të të akuzuarve. Veprimet e të akuzuarve përmbushin elementet e veprës penale Rrëmbim

sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Prandaj, duke pasur parasysh se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, Gjykata e Apelit ri-cilëson aktet e të akuzuarve B.K., D.I., H.K., Ahmed Neziraj, H.K. dhe S.G. që përbëjnë veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Kolegji vëren se Kodi Penal në fuqi në kohën kur janë kryer veprat penale dhe i zbatuar më lartë (KPK-ja) nuk është më tutje në fuqi. Më 1.01.2013 Kodi i ri Penal (Ligji nr. 04/L-082) ka hyrë në fuqi në Kosovë. Neni 3 i Kodit Penal në fjalë (paraprakisht neni 2 në KPK) ka ruajtur parimin themelor të ligjit penal të zbatimit të ligjit më të favorshëm. Kolegji ka shqyrtuar dispozitat relevante për të akuzuarin në lëndën përkatëse dhe ka përcaktuar se Kodi Penal i ri i cili është në fuqi prej 1.01.2013 nuk është më i favorshëm për të akuzuarin. Rrjedhimisht, zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale – KPK-ja.

#### **D.2. Vepra penal e Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe Ligji per Amnistinë**

Lidhur me veprat penale nën pikat 2.1 dhe 4 të aktgjykimit të apeluar, Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë ligjin penal kur ka konstatuar se veprimet e të pandehurit B.K. përmbajnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 (3) të KPK-së, kurse veprimet e të akuzuarit H.K. përmbajnë elementet e veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 (1) të KPK-së.

Gjatës seancës pranë Gjykatës së Apelit, Prokurori i Apelit ka tërhequr aktakuzën kundër të akuzuarit D.I. (Pika 3) dhe të akuzuarit H.K. (Pika 5) për veprat penale sipas nenit 328 (2) të KPK-së.

Nenet 2.1 dhe 3 (1.2.5) të Ligjit për amnistinë përjashtojnë veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 (2) të KPK-së nga ndjekja penale. Asnjëri nga përjashtimet në nenin 4 të Ligjit për amnisti nuk është i zbatueshëm. Prandaj, pikat 3 dhe 5 të akuzës kundër D.I.t dhe H.K.t refuzohen sipas nenit 389 (4) të KPPK-së.

Kolegji vëren se pasi që Prokurori gjithashtu ka tërhequr këto akuza, gjithashtu janë përmbushur kushtet për refuzimin e akuzës sipas nenit 389 (1) të KPPK-së. Rezultati është i njëjtë – akuzat për këto pika duhet patjetër të refuzohen.



## E. Vendimi mbi dënimin

Avokatët mbrojtës në ankesat e tyre gjithashtu kundërshtojnë edhe sanksionet e shqiptuara penale.

Kolegji sqaron se pasi që cilësimi juridik i veprave penale ka ndryshuar, rrjedhimisht kjo kërkon caktimin e dënimeve përsëri brenda kufijve të përcaktuar për këtë veprë të veçantë. Gjykata e Apelit, pas ri-cilësimit të akteve të akuzuarve përkatës për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159(2) të KPK-së, gjithashtu duhet patjetër të përcaktoj dënimin e përshtatshëm brenda kufijve të përcaktuar me ligj për këtë veprë penale.

Gjatë marrjes së vendimit kolegji gjithashtu ka marrë parasysh edhe argumentet e ankuesve lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me këtë. Kolegji në vijim do t'i diskutoj këto çështje në hollësi.

Kolegji sqaron se sa i përket B.K. nuk është bërë asnjë ndryshim lidhur me shpalljen e tij fajtor dhe dënimin e caktuar për veprën penale sipas nenit 328(3) të KPK-së. E njëjta vlen edhe për të pandehurin H.K. dhe shpalljen e tij fajtor dhe dënimin e caktuar për veprën penale sipas nenit 328(1) të KPK-së. Prandaj, kolegji i konsideron këto dënime si të vendosura gjatë përcaktimit të dënimit unik për të dy të pandehurit në pajtim me nenin 71 të KKP-së.

Në kuptim të nenit 64 të KPK-së, kufiri ligjor i përcaktuar për krimin specifik është pikënisje për përcaktimin e sanksioneve penale. Gjykata ka autoritet diskrecional të bëjë përfundime, sipas kushteve të përcaktuara me nenet 66 dhe 67 të KPK-së, nga një orientim i tillë, por vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara, siç janë përcaktuar me këto dispozita. Me individualizimin e dënimit – përmes procesit të matjes së dënimit, ashpërsia e veprës penale relativizohet dhe në këtë rast duhet pasur parasysh se dënimi sipas ashpërsisë duhet të përmbush qëllimet e dënimit, i cili sipas udhëzimeve ligjore, duhet të manifestoj një balancim të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit duhet t'i lejohet risocializimi përmes edukimit dhe kërkesa publike që mënyra dhe kohëzgjatja e dënimit duhet të ketë karakter të preventivës së përgjithshme që do ta parandalonte atë që të kryejë vepra penale (preventiva e përgjithshme dhe individuale).

### Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë (aktgjykimi i kundërshtuar)

Gjykata e shkallës së parë, gjatë përcaktimit të dënimit kundër të akuzuarve, ka marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprave penale, por gjithashtu edhe sjelljen e rrëmbyesve ndaj viktimës A.M., kërcënimin që i ishte bërë atij dhe familjes së tij për marrjen e jetës së A.M. dhe shkatërrimin e biznesit të tyre familjar, kërkesën e haraçit dhe faktin se i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën e parë, si rrethana rënduese (për të gjithë të

akuzuarit). Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë ka specifikuar rrethanat shtese rënduese dhe lehtësuese për secilin të akuzuar si në vijim:

Lidhur me të akuzuarin B.K., përveç rrethanave të përmendura më lart, gjykata ka marrë parasysh si rrethana rënduese gjithashtu edhe rolin e tij udhëheqës në grup dhe faktin se gjatë kryerjes së veprave penale ai ka qenë kundërligjshëm në arrati.

Lidhur me të akuzuarin D.I., përveç rrethanave të përmendura më lart, gjykata ka marrë parasysh kontributin e tij në përmbushjen e kërkesës për haraç, kërcënimet e bëra kundër palës së dëmtuar, dhe faktin në atë kohë ishte lëshuar urdhri për arrest kundër tij për një vepër tjetër penale, si rrethanë rënduese.

Njësoj, lidhur me të akuzuarin H.K., gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh rrethanat e njëjta rënduese si më lart, por gjithashtu edhe kontributin e tij – ruajtja e Azem Morinës gjersa ky i fundit ishte në mbajtje dhe se kishte qenë i armatosur. Gjukata ka marrë parasysh moshën e tij të re dhe se për shkak të moshës së tij ai mund të ketë qenë nën ndikimin e vëllait të tij B.K.t, si rrethanë lehtësuese.

Lidhur me të akuzuarin A.N., gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh, përveç rrethanave të përmendura më lart, rolin e tij të rëndësishëm logjistik në rrëmbim dhe shkallën e përgjegjësisë së tij penale, sepse në atë kohë ai ka qenë polic i Policisë së Kosovës, me përgjegjësi dhe i cili ka pasur besimin e mirë të komunitetit, si rrethana rënduese. Gjukata ka marrë parasysh rrethanat e tij familjare si rrethana lehtësuese.

Lidhur me të akuzuarin H.K., gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh faktin se ai dhe D.I. (duke e xhiruar dhe duke i bërë presion viktimës) kanë kontribuar në përmbushjen e kërkesës për haraç, si rrethana rënduese.

Lidhur me S.G.n, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh kontributin e tij në transportimin e palës së dëmtuar në lokacionin ku është mbajtur gjatë asaj kohe dhe vëzhgimi i B.M. më 9 tetor 2010, si faktorë rëndues.

### Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjukata e Apelit vëren se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me pranimin e fajësisë për veprat penale sipas nenit 328 (2) të KPK-së për të pandehurit D.I. dhe H.K. nuk janë më tutje relevante si rrethana lehtësuese pasi që këto akuza janë refuzuar nga Gjukata e Apelit (shih më lart).

Lidhur me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë për rrethanat rënduese dhe lehtësuese,

Gjykata e Apelit thekson se fakti që i pandehuri nuk ka pranuar fajësinë nuk është rrethanë rënduese. Përfundimi i trupit gjykues në lidhje me këtë ishte i pasaktë.

Gjersa pranimi i fajësisë gjatë fazës së hershme në procedurë mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, mungesa e saj nuk është faktor rëndues. Kjo rrjedh nga parimi *nemo tenetur se ipsum accusare* se as refuzimi i të akuzuarit për të bashkëpunuar në mënyrë aktive me autoritetet e shtetit gjatë procedurës penale e as mënyra në të cilën i pandehuri e zhvillon mbrojtjen e tij nuk mund të konsiderohen rrethana rënduese. Varet nga i akuzuari që të vendosë strategjinë e tij të mbrojtjes si dhe nëse dhe si dëshiron t'i ushtrojë të drejtat e tij për mbrojtje. Nëse i akuzuari, sikur në lëndën në fjalë, vendos që t'i kundërshtoj akuzat në tërësi ai gjithashtu nuk do ta pranonte fajësinë. Prandaj, duke pasur parasysh këtë të fundit si rrethanë rënduese do të ndërhynte në të drejtat themelore të të akuzuarit për mbrojtje.<sup>6</sup>

Më tutje, në mendimin e Gjykatës së Apelit, kërcënimi i bërë ndaj palës së dëmtuar me vdekje dhe shkatërrimi i biznesit të tij nuk mund të konsiderohen si rrethana rënduese sepse tashmë përbën elementin cilësues të veprës penale Rrëmbim. Prandaj, paragrafi (2) i nenit 159 të KPK-së përcakton: Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ... si anëtar i grupit ose kryerësi e kërcënon personin e rrëmbyer me vdekje ose me shkaktim të dëmtimit të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet.

Përfundimet e mbetura të gjykatës së shkallës së parë janë të sakta dhe gjithashtu janë marrë parasysh edhe nga Gjykata e Apelit gjatë përcaktimit të dënimeve.

B.K., D.I., H.K., A.N, S.G. dhe H.K. janë shpallur fajtorë për Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së, për të cilën përcaktohet dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Veprat penale ishin kryer ne bashkëkryerje.

Avokatët mbrojtës të të akuzuarave në ankesat e tyre nuk kanë nënvizuar asnjë rrethanë të veçantë që do të ndikonte në kohëzgjatjen e dënimeve (zvogëlimin e dënimit).

Gjykata e Apelit konsideron se dënimet e shqiptuara tani kundër të pandehurve janë në harmoni me intensitetin e vlerës së mbrojtur, nivelin e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si kryerës të veprave penale dhe se këto dënime do të shërbejnë si preventivë e përgjithshme, preventivë e veçantë, dhe shkojnë në drejtim të fuqizimit të moralit shoqëror dhe përgjegjësisë dhe disiplinës, dhe janë në pajtim me kushtet për sigurinë personale të popullsisë në këtë zonë, dhe se këto dënime do ta arrijnë qëllimin e tyre të përcaktuar me nenin 34 të KPK-së.

---

<sup>6</sup> Shih gjithashtu aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Pakr 1122/12 të datës 25.04.2013, par. 59.

Kolegji shqiptoi dënimet e përcaktuara në dispozitiv ndaj B.K, D.I. dhe A.N. me vendim të shumicës. Dënimet e caktuara ndaj H.K. H.K. dhe S.G. janë vendosur me vendim unanimit të kolegjit.

Kolegji dënoi të pandehurin B.K. me burgim në kohëzgjatje prej 10 viteve për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së. Kolegji u pajtua me gjykatën e shkallës së parë lidhur me denimin nën pikën 2.1 për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (3) të KPK-se (tri vjet burgim). Kolegji konsideron se denimi i drejte unik do të jete dymbëdhjete (12) vjet burgim.

Kolegji dënoi të pandehurin D.I. me burgim në kohëzgjatje prej 8 viteve për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Kolegji dënoi të pandehurin H.K. me burgim në kohëzgjatje prej 6 për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së. Kolegji u pajtua me gjykatën e shkallës së parë lidhur me denimin nën pikën 4 për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (3) të KPK-se (dy vjet burgim). Kolegji konsideron se denimi i drejte unik do të jetë shtatë (7) vjet burgim.

Kolegji dënoi A.N. me burgim në kohëzgjatje prej 9 viteve për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Kolegji dënoi H.K. me burgim në kohëzgjatje prej 6 viteve për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Kolegji dënoi S.G. me burgim në kohëzgjatje prej 6 viteve për veprën penale Rrëmbim sipas nenit 159 (2) të KPK-së.

Periudhat e kaluara në paraburgim janë llogaritur në dënimet e të gjithë të akuzuarve të përmendur më lart.

Lidhur me të akuzuarin I.L., siç është cekur më lart, ai LIROHET NGA AKUZAT. Paraburgimi i të akuzuari I.L. është ndërprerë me anë të aktvendimit të veçantë të lëshuar më 15 maj 2014.

## **F. Cështjet tjera**

Shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin I.L. do të paguhen nga burimet buxhetore.

Pjesa liruese (Pika 2.2 e dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar) mbetet e pandryshuar sikurse edhe të gjitha pjesët tjera të aktgjykimit të kundërshtuar të cilat nuk janë ndryshuar.

Sipas nenit 9 të Ligjit për amnisti, Nr. 04/L-209, përkundër zbatueshmërisë së amnistisë për këtë vepër penale, vendimi i gjykatës së shkallës së parë mbi konfiskimin e armëve konfirmohet, dhe edhe pse i akuzuari ka përfituar nga amnistia për këtë vepër penale ai nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e armëve të konfiskuara.

Përveç kësaj, vendimi i gjykatës së shkallës së parë mbi konfiskimin e telefonit Nokia 6300, me numër IMEI 1.....0 (3.....0), dhe konfiskimin e veturës Toyota 4-Runner, me numër të shasisë K.....1, 8.....1, me numër të tabelave ....., në pronësi të A.N., konfirmohet.

Si është theksuar më lart, sipas nenit 426 të KPPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

*Aktgjykimi është hartuar në gjuhën shqipe dhe është finalizuar në gjuhën angleze. Aktgjykimi i arsyetuar është kompletuar më 21 tetor 2014.*

### **Kryetar i kolegjit**

---

Timo Vuojolahti, Gjyqtar i EULEX-it

### **Anëtarët e kolegjit**

---

Tonka Berishaj, Gjyqtare e Kosovës

---

Annemarie Meister, Gjyqtare e EULEX-it

**Procesmbajtëset**

---

Beti Hohler, Zyrtare ligjore e EULEX-it, dhe

---

Vjollca Gërxhaliu-Kroçi, Këshilltare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR. Nr. 1282/2012**

**28 maj 2014**

**(përfunduar më 21 tetor 2014)**

